



BOTIM TEMATIK:  
Procesi i negocijimit dhe  
propozimi për statusin e Kosovës



Raporti i të Dërguarit Special të Sekretarit  
të Përgjithshëm për statusin e ardhshëm të Kosovës  
Kosova meriton t'i qartësohet plotësisht e ardhmja e saj

## EDITORIAL



Nëse shqyrtojmë katërmbëdhjetë muajt e fundit të zhvillimit të negociatave, do të vërejmë që Kosova ka ndryshuar shumë. Kur i Dërguari Special Martti Ahtisaari arriti për herë të parë në Prishtinë në nëntor të vitit 2005, Kosova sapo kishte themeluar Ekipin e Unitetit, një ushtrim i unitetit politik në nivelin më të lartë që nuk ishte praktikuar më herët. Presidenti Ibrahim

Rugova, Kryeministri Bajram Kosumi, Kryetari i Kuvendit Nexhat Daci, Kryetari i PDK-së Hashim Thaçi dhe Kryetari i ORA-s Veton Surroi vunë themelet. Viti 2006 filloi me zhvillime të rëndësishme në skenën politike të Kosovës. Vdekja e Presidentit Rugova, i cili u zëvendësua me Profesor Fatmir Sejdiun, si dhe zëvendësimet e Kryeministrit Kosumi me Z. Agim Çekun. dhe Kryetarit të Kuvendit Daci me Z. Kolë Berishën, lanë gjurmët e veta në procesin e negociimit. Gjatë gjithë negociatave, ky unitet është mbajtur, derisa në disa raste, Kuvendi i Kosovës është informuar dhe ka debatuar mbi procesin e negociatave. Kjo konfirmoi rolin kyç që Kuvendi i Kosovës duhet të luajë në periudhën e ardhme.

Procesi i negociatave ishte kompleks dhe i multilateral në natyrën e tij – përvojë që udhëheqësit e Kosovës do ta vlerësojnë edhe më shumë kur perspektiva evropiane e Kosovës të marrë dinamikën e saj të plotë. Gjatë vitit 2006, UNOSEK ka mbajtur 15 runde të bisedimeve direkte mes ekipeve negociuese të Beogradit dhe Prishtinës. 14 nga këto rrathë bisedimesh janë përqendruar në decentralizim, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare në Kosovë, çështjet ekonomike, si dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve. Dy takime tjera u mbajtën me praninë e zyrtarëve më të lartë nga të dyja anët. Që nga janari 2006, 26 misione ekspertësh të udhëhequra nga UNOSEK-u kanë vizituar Beogradin dhe Prishtinën për të biseduar ndaras me palët mbi çështje të ndryshme. Më 26 mars 2007, u publikua rekomandimi për statusin politik të Kosovës nga Sekretari i Përgjithshëm i KB-së Ban Ki Moon, pas një pune të jashtëzakonshme të bërë nga i Dërguari Special Martti Ahtisaari. Ky botim i Buletinit ASI ofron një pasqyrë të detajizuar të procesit negociator nga parë nga këndvështrime të ndryshme. Ne kemi vënë në dispozicionin tuaj mendime të ndryshme, duke përfshirë edhe vetë Propozimin për Zgjidhjen e Statusit, si dhe një shqyrtim të procesit negociator nga perspektiva e Kosovës. Me këtë rast disa anëtarë të Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës kanë kontribuar mbi këtë temë në këtë numër. Shpresojmë që këto informata të jenë të dobishme për ju.

*Franklin De Vrieze,  
Koordinator i Iniciativës për Mbështetjen e Kuvendit*

Botim tematik:

Procesi i negociimit dhe propozimi për statusin e Kosovës

|                                                                                                           |    |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Raporti i të Dërguarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për statusin e ardhshëm të Kosovës           | 3  |
| Deklaratë e Kuvendit të Kosovës                                                                           | 5  |
| Pavarësia e Kosovës është alfa dhe omega                                                                  | 6  |
| “Nuk janë shterur mundësitë për bisedime shtesë”                                                          | 8  |
| E ardhmja e Kosovës                                                                                       | 9  |
| Kosova meriton t’i qartësohet plotësisht e ardhmja e saj                                                  | 10 |
| Tre skenarë të zhvillimeve për Kosovën                                                                    | 11 |
| “Delegacioni i Kosovës është angazhuar përmbylljen me sukses të procesit”                                 | 13 |
| ShBA përkrahin rekomandimin e Ahtisarit për status S’ka Kushtetutë pa përfaqësim                          | 16 |
| Përmbledhje e përgjithshme e propozimit gjithëpërfshirës përfundimtar për zgjidhjen e statusit të Kosovës | 17 |
| Hapat drejt definimit statusit të Kosovës                                                                 | 18 |
| Misioni i ri i BE-së do të bështesë aspiratat e Kosovës për anëtarësim në BE dhe NATO                     | 21 |
| “Plani i Ahtisaarit do të sigurojë përparim dhe kuptim të ri për bashkë-jetesën në Kosovë”                | 22 |
| Shtojca VIII e Pakos së Ahtisarit                                                                         | 24 |
| Parlamenti Evropian mbështetë Raportin mbi Kosovën                                                        | 25 |
| BE-ja do të ketë rol udhëheqës në Kosovë                                                                  | 26 |
| Kosovës i duhet angazhimi ndërkombëtar                                                                    | 27 |
| BE-ja mbështetë ndërtimin e së ardhmes së Kosovës                                                         | 28 |
| Deputetët me “duar të lidhura”                                                                            | 29 |
| Kosovës i është ofruar mundësia                                                                           | 33 |
| Për statusin e Kosovës dhe pas Ahtisaarit                                                                 | 34 |
| Procesi i definimit të statusit të Kosovës: të arriturat dhe mangësitë                                    | 35 |



# Raporti i të Dërguarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për statusin e ardhshëm të Kosovës

*Martti Ahtisaari, i Dërguari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës*

**Rekomandimi:**  
Statusi i Kosovës duhet të jetë pavarësi e mbikëqyrtur nga komuniteti ndërkombëtar

1. Në nëntor të vitit 2005, Sekretari i Përgjithshëm më emëroi të Dërguar Special për Procesin e statusit të ardhshëm për Kosovën. Sipas përshkrimit të detyrave të mia, ky proces duhet të përmbyllet (kurorëzohet) me zgjidhjen politike, që përcakton statusin e ardhshëm të Kosovës. Për të arritur zgjidhjen e tillë politike, gjatë vitit të kaluar kam zhvilluar negociata me udhëheqësitë e Serbisë dhe Kosovës. Ekipi im dhe unë kemi bërë çdo përpjekje për të bërë të mundur një rezultat, që do të ishte i pranueshëm për të dyja palët. Por, pas më shumë se një viti të bisedimeve të drejtpërdrejta, negociatave bilaterale dhe konsultimeve me ekspertë, më është bërë e qartë, që palët nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje mbi statusin e ardhshëm të Kosovës.

2. Gjatë gjithë procesit dhe në një numër rastesh, të dyja palët kanë ripohuar qëndrimet e tyre kategorike, diametralisht të kundërta: Beogradi kërkon autonominë e Kosovës në kuadër të Serbisë, derisa Prishtina nuk do të pranojë asgjë më pak se pavarësi. Madje edhe mbi çështjet praktike si decentralizimi, të drejtat e komunitetit, mbrojtja e trashëgimisë kulturore e fetare dhe çështjet ekonomike, dallimet konceptuale-gati gjithmonë këmbëngulnin lidhur me



çështjen e statusit, - dhe u arrit vetëm një progres i vogël.

3. Mandati im parashikon qartë që unë të caktojë rrjedhën dhe kohëzgjatjen e procesit të statusit të ardhshëm në bazë të konsultimeve me Sekretarin e Përgjithshëm, duke e marrë parasysh bashkëpunimin e palëve dhe situatën në terren. Është bindja ime e thellë: që është shterur potenciali i negociatave për të dalë me ndonjë rezultat të përbashkët dhe të pajtueshëm mbi statusin e Kosovës. Kurrfarë bisedimesh shtesë, çfarëdo lloji të jenë, nuk do t'a tejkalonin këtë qorrrokak.

4. Megjithatë, është e nevojshme që të bëhet zgjidhja e kësaj çështjeje themelore. Kanë kaluar gati tetë vite, që kur Këshilli i Sigurimit ka miratuar Rezolutën 1244 (1999) dhe gjendja e tanishme e paqartë e Kosovës nuk mund të vazhdojë më. Paqartësia mbi statusin

e saj të ardhshëm është bërë pengesë kryesore për zhvillimit demokratik të Kosovës, llogaridhënien, rimëkëmbjen ekonomike dhe pajtimin ndër-etnik. Kjo pasiguri çon vetëm në stagnimin e mëtutjeshëm, polarizimin e komuniteteve, duke rezultuar kështu në trazira sociale dhe politike. Të sillemi ndryshe, çfarëdo mohimi apo vonimi i zgjidhjes së statusit të Kosovës, sfidon jo vetëm stabilitetin e saj, por paqen dhe stabilitetin e rajonit në tërësi.

5. Ka ardhur koha për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Duke e shikuar me kujdes historinë e kohës së fundit të Kosovës, realiteti i Kosovës së sotme, duke i marrë parasysh negociatat me palët, kam ardhur në përfundim, që opsioni i vetëm i realizueshëm për Kosovën është pavarësia, që do të mbikëqyrej fillimisht për një kohë nga bashkësia ndërkombëtare. Propozimi im

gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, me struktura mbikëqyrtëse ndërkombëtare, siguron themelet për Kosovën e ardhshme të pavarur, që është e realizueshme, qëndrueshme dhe stabile dhe në të cilën të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre mund të jetojnë në paqe dhe në mënyrë dinjitoze.

Rikthimi brenda Serbisë nuk është opsion që mund të ketë sukses

6. Historia e armiqësisë dhe mosbesimit ka shoqëruar për një kohë të gjatë marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës. Ky raport i vështirë është përkeqësuar me veprimet e regjimit të Millosheviqit në vitet e 90-ta. Pas viteve të rezistencës paqësore ndaj politikave shtypëse të Millosheviqit – revokimit të autonomisë së Kosovës, diskriminimit sistematik kundër shumicës dërmuese shqiptare në Kosovë dhe eliminimit efektiv të tyre nga jeta publike – shqiptarët e Kosovës përfundimisht reagojnë me rezistencë të armatosur. Pas kësaj erdhi represioni i përforcuar dhe brutal i Beogradit, duke shkaktuar humbjen tragjike të jetërave civile, zhvendosjen dhe dëbimin në shkallë masive të shqiptarëve të Kosovës nga shtëpitë e tyre, si dhe nga Kosova. Përkeqësimi dramatik i gjendjes në terren nxiti intervenimin e Organizatës së Traktatit Veri-Atlantik (NATO), që kulmoi me miratimin e rezolutës 1244 (1999), më 10 qershor, 1999.

7. Për tetë vitet e kaluara, Kosova dhe Serbia janë udhëhequr plotësisht të ndara nga njëra tjetra. Themelimi i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), në bazë të Rezolutës 1244 (1999), si dhe marrja e gjitha kompetencave legislative, ekzekutive dhe gjyqësore në gjithë Kosovën nga ky Mision, ka krijuar gjendjen në të cilën Serbia nuk ka ushtruar kurrfarë juridiksioni mbi Kosovën. Ky është realitet që askush nuk mund ta mohojë; është i pakthyeshëm. Kthimi i pushtetit serb mbi Kosovën do të ishte i papranueshëm për shumicën dërmuese të njerëzve në Kosovë. Beogradi nuk do të mund të rimerrte pushtetin pa shkaktuar një kundërshtim të dhunshëm. Autonomia e Kosovës brenda kufijve të Serbisë – çfarëdo kuptimi që të ketë ajo – është thjesht e paqëndrueshme.

**Vazhdimi i administrimit ndërkombëtar nuk është i qëndrueshëm**

8. Ndonëse, UNMIK-u ka arritur rezultate të konsiderueshme në Kosovë, ky administrim ndërkombëtar i Kosovës nuk mund të vazhdojë. Nën autoritetin e UNMIK-ut, institucionet e Kosovës janë krijuar e zhvilluar, si dhe kanë marrë përgjegjësi, përditë e më shumë, në menaxhimin e çështjeve të Kosovës. Kjo ka vënë në lëvizje një proces dinamik politik, i cili ka përforcuar edhe pritjet legjitime të popullit të Kosovës për më shumë pronësi, si dhe përgjegjësi, në punët e tyre. Këto pritje nuk mund të realizohen brenda kornizës së një administrimi të vazhduar ndërkombëtar.

9. Së këndejmi, derisa UNMIK-u ka ndihmuar institucionet

vendore të vetë-qeverisjes, ai nuk ka qenë në gjendje të zhvillojë një ekonomi të qëndrueshme. Statusi i pasigurt politik i Kosovës i ka pamundësuar asaj qasjen në institucionet financiare ndërkombëtare, integrimin e plotë në ekonominë rajonale, apo tërheqjen e kapitalit të jashtëm i cili i nevojitet për të investuar në infrastrukturën themelore, si dhe ulur varfërinë dhe papunësinë e madhe. Ndryshe nga shumë fqinjë ballkanikë, Kosova nuk ka mundësinë e pjesëmarrjes efektive në ndonjë proces kuptimplotë drejt Bashkimit Evropian – që përndryshe është shtytës i fuqishëm i reformave dhe zhvillimit ekonomik në rajon dhe mënyra më frytdhënëse për të vazhduar procesin jetik të plotësimin të standardeve. Ekonomia e dobët e Kosovës, me pak fjalë, është burim i jostabilitetit shoqëror dhe politik dhe ringjallja e saj nuk mund të arrihet nën "status quo"-në e administrimit ndërkombëtar. Zhvillimi ekonomik në Kosovë kërkon qartësinë dhe stabilitetin që mund të sigurohet vetëm me pavarësi.

**Pavarësia me mbikëqyrje ndërkombëtare është zgjidhja e vetme e cila mund të ketë sukses**

10. Pavarësia është mundësia e vetme për një Kosovë politiki-shtet stabile dhe ekonomikisht të qëndrueshme. Vetëm në një Kosovë të pavarur, institucionet e saj demokratike do të jenë plotësisht përgjegjëse dhe të përgjegjshme për veprimet e tyre. Kjo do të ishte thelbi i ndërtimit dhe respektimit për sundimin e ligjit dhe mbrojtjen efikase të pakicave. Vazhdimi i dykuptimisë së politike,

paqja dhe stabiliteti i Kosovës dhe rajonit mbeten të rrezikuara. Pavarësia është masa më e mirë mbrojtëse ndaj këtij rreziku. Është gjithashtu edhe mundësia më e mirë për partneritetin afatgjatë mes Kosovës dhe Serbisë.

11. Derisa pavarësia e Kosovës është i vetmi opsion realist, kapaciteti i Kosovës për t'u ballafaquar me sfidat e mbrojtjes së pakicave, zhvillimet demokratike, ringjalljen ekonomike dhe pajtimin shoqëror është ende i kufizuar. Institucionet politike dhe ligjore të Kosovës duhet të zhvillohen tutje, me ndihmën ndërkombëtare dhe nën mbikëqyrjen ndërkombëtare. Kjo fiton rëndësi të veçantë në kuptimin e mbrojtjes së popujve më të ndjeshëm të Kosovës dhe pjesëmarrjen e tyre në jetën publike.

12. Bashkësitë pakicë në Kosovë – sidomos serbët e Kosovës – vazhdojnë të ballafaqohen me kushte të vështira të jetesës. Dhuna e kryer ndaj tyre në verën e 1999-ës dhe në marsin e 2004-ës, ka lënë pasojë të thella. Derisa udhëheqësitë kosovarë kanë shtuar përpjekjet e tyre për t'u afruar me serbët e Kosovës dhe për të përmirësuar plotësimin e standardeve, mbrojtja e të drejtave të komuniteteve pakicë kërkon përkushtim edhe më të madh. Njëkohësisht, serbët kosovarë duhet të angazhohen në mënyrë aktive në institucionet e Kosovës. Ata duhet të ndërrojnë qëndrimin e tyre fundamental të mos-bashkëpunimit; vetëm me ndalimin e bojkotimit të institucioneve të Kosovës, ata do të kenë mundësinë e mbrojtjes efektive të të drejtave dhe interesave të tyre.

13. Kështu që propozojë që ushtrimi i pavarësisë së Kosovës, si dhe plotësimi i obligimeve të saj të paraqitura me propozimin e Zgjidhjes, të mbikëqyren dhe të përkrahen për një periudhë fillestare nga prania ndërkombëtare civile dhe ushtarake. Fuqitë e tyre duhet të jenë të mëdha – por të përqendruara – në fushat kritike, si të drejtat e bashkësive etnike, decentralizimi, mbrojtja e kishës ortodokse serbe, si dhe sundimi i ligjit. Këto kompetenca duhen ushtruar për të korrigjuar veprimet që do të ishin në kundërtënie me dispozitat e propozimit të Zgjidhjes si dhe frymës në të cilën ato janë hartuar. Duke njohur dobësitë e tanishme të Kosovës, angazhimi intensiv i bashkësisë ndërkombëtare duhet të mbulojë edhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale. Unë parashikoj që roli mbikëqyrës i bashkësisë ndërkombëtare do të përfundojë vetëm kur Kosova të ketë zbatuar masat e parashtruara me propozimin për Zgjidhje.

14. Pa anashkaluar këtë përfshirje të fuqishme ndërkombëtare, autoritetet kosovare janë përfundimisht përgjegjëse dhe të llogaridhënëse për zbatimin e propozimit të Zgjidhjes. Ato do të jenë të suksesshme në këtë përpjekje vetëm me përkushtimin dhe pjesëmarrjen aktive të të gjitha komuniteteve, duke përfshirë, në veçanti, atë të serbëve të Kosovës.

**Përfundim**

15. Kosova është rast unik që kërkon zgjidhje unike. Ajo nuk krijon presedan për konflikte tjera të pazgjidhura. Në miratimin e njëzëshëm të Rezolutës 1244 (1999), Këshilli



i Sigurimit i dha përgjigjen veprimeve të Millosheviqit në Kosovë, duke i privuar Serbisë rolin në qeverisje, duke e vënë Kosovën nën administrimin e përkohshëm të Kombeve të Bashkuara, duke parashikuar procesin politik të dizajnuar për përcaktimin e së ardhmes së Kosovës. Kombinimi i gjithë këtyre faktorëve i bën rrethanat e Kosovës të jashtëzakonshme.

16. Për më shumë se një vit, e kam udhëhequr procesin politik, të paraparë me Rezolutën 1244 (1999), duke shterur çdo mundësi për të arritur një zgjedhje të negociueshme. Qëndrimet kundërthënëse të palëve e kanë bërë kompromisin të porealizueshëm. Megjithatë, pas gati tetë viteve të administratës së Kombeve të Bashkuara, statusi i Kosovës duhet të zgjidhet urgjentisht. Rekomandimi im për pavarësi të mbikëqyrtur fillimisht nga bashkësia ndërkombëtare, merr parasysh historinë e kohës së fundit të Kosovës, realitetin në Kosovën e sotme dhe nevojën për stabilitet politik dhe ekonomik në Kosovë. Propozimi im për pavarësi, mbi të cilin do të bazohet pavarësia e tillë, ndërtohet mbi qëndrimet e palëve në procesin e negociatave dhe ofron kompromise mbi shumë çështje për të arritur një zgjedhje jetëgjatë. Do të insistoj që Këshilli i Sigurimit ta miratojë propozimin tim për zgjedhje. Duke e përmbyllur këtë episod të fundit në shpërbërjen e ish Jugosllavisë, do t'ia mundësojë rajonit që të fillojë një kapitull të ri në historinë e tij- kapitull i cili bazohet në paqe, stabilitet dhe prosperitet për të gjithë.

26 mars 2007

## *Deklaruan pas bërjes publike të rekomandimit të Kryenegociatorit Ahtisaari*

**Fatmir Sejdiu:** Pavarësia e Kosovës, e cila fillimisht, sipas planit të Ahtisarit, do të ketë mbikëqyrje ndërkombëtare, do të jetë në shërbim të paqes, të stabilitetit dhe prosperitetit të përgjithshëm të vendit tonë. (Express, 27 mars 2007)

**Agim Çeku:** Pakoja e të dërguarit special të Kombeve të Bashkuara për statusin e Kosovës, e hartuar me bekimin e OKB-së, ka mbështetjen e fuqishme të Uashingtonit, Londrës, Parisit, Brukselit, e shumë e shumë qendrave të tjera. Pres që edhe të lëkundurit, apo ata që kanë kundërshti ndaj propozimit, të kuptojnë se procesi Ahtisaari në mos qoftë më i miri, është i vetmi opsion realist; e vetmja zgjidhje praktike. (Nga fjalimi javor i kryeministrit në Radio Kosovë, 26 mars 2007)

**Kolë Berisha:** Kosova e ka pritur me entuziazëm këtë moment, i cili ka rëndësi të jashtëzakonshme. Kosova po pavarësohet. (Deklaratë për media, 27 mars 2007)

**Hashim Thaçi:** Të gjithë qytetarët e Kosovës duhet të ndihen krenar sepse të gjithë kanë luajtur rol të rëndësishëm në momente të rëndësishme të historisë së re të Kosovës. Në javët që vijnë na presin sfida të reja dhe obligime të përgjegjësi institucionale si politikë, edhe si popull. (Express, 27 mars 2007)

**Veton Surroi:** Presidenti Ahtisaari ka rekomanduar një Kosovë të pavarur dhe të barabartë me shtetet e tjera. Ky rezultat, kjo pako, është fryt i sakrificave dhe gjeneratave të tëra të Kosovës. (Express, 27 mars 2007)

**Skender Hyseni:** Ekipi i Unitetit e ka quajtur ditë historike ditën e hënë (26 mars 2007) dhe dorëzimin e rekomandimit të Marti Ahtisarit në KS të OKB-së, si dhe me këtë rast u ka shprehur mirënjohje të thellë Ahtisarit dhe sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki Moon. (Koha Ditore, 28 mars 2007)

**Blerim Shala:** Përkrahja e rezervë të Ban Ki Moon-it për raportin dhe paketën e Ahtisarit mund të luaj rol kyç në miratimin e rezolutës së re të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Kosovën. (Zëri, 27 mars 2007)

## *Deklaratë e Kuvendit të Kosovës në mbështetje të Raportit të Marti Ahtisarit,*

*Kuvendi i Kosovës, përmes kësaj Deklarate*

Mirëpret Raportin Final të të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara për Procesin e Statusit të Kosovës, të paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 mars 2007, të bindur që rekomandimet e tij paraqesin një zgjidhje të drejtë dhe të balancuar, që është në përputhje me vullnetin e popullit të Kosovës.

Kuvendi i Kosovës pranon dhe zotohet të implementojë plotësisht Propozimin Gjithëpërfshirës të Marrëveshjes për Statusin e Kosovës, të paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 mars 2007, dhe deklaron, nën supozimin që Marrëveshja është e pranueshme për Këshillin e Sigurimit, se dispozitat që i përmban Marrëveshja do të jenë ligjështetë të obligueshme për Kosovën.

Mirëpret pa rezervë praninë ndërkombëtare civile dhe të sigurisë që do të krijohet në Kosovë, siç parashihet në Marrëveshje, dhe zotohet se do të bashkëpunojë dhe do ta mbështesë këtë prani në çdo mënyrë të mundshme, përderisa kjo prani ndërkombëtare civile dhe e sigurisë t'i kryejë detyrat që i janë përcaktuar sipas kësaj Marrëveshjeje.



5 prill 2007 Prishtinë

# Pavarësia e Kosovës është alfa dhe omega

*Fatmir Sejdiu, President i Kosovës dhe udhëheqës i Ekipit Negociator të Kosovës*

Është kjo hera e tretë brenda nëntë muajsh që më jepet rasti dhe nderi t'i drejtohem këtij trupi të lartë të OKB-së. Ju drejtohem si President i Kosovës dhe udhëheqës i Ekipit Negociator të Kosovës, që është mbiquajtur Ekipi i Unitetit, i cili përbëhet nga spektri politik qeverisës dhe opozitar.

Më 10 mars në Vjenë, Austri, është përmbjllur një proces i gjatë dhe kompleks negociatash dhe bisedimesh për përcaktimin e statusit të Kosovës. Procesi i udhëhequr nga ish-Presidenti finlandez Martti Ahtisaari, Emisar i OKB-së për statusin e Kosovës, ka prodhuar një dokument, emërtimi zyrtar i të cilit është "Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës", i cili nis kapitullin e fundit të zgjidhjes së çështjes së Kosovës një herë e mirë.

E kemi thënë në fillim të procesit dhe e përsërisim se pavarësia e Kosovës është alfa dhe omega – është çështje ekzistenciale për popullin tonë. Asnjë lidhje strukturore me institucionet shtetërore të Serbisë nuk është e pranueshme për ne. Pavarësia e vendit tonë është në rend të parë pavarësi nga Serbia, si një parakusht vendimtar për paqen dhe stabilitetin në rajon dhe për fillimin e një procesi kuptimplotë për integrimin e Kosovës dhe të Serbisë, si vende të pavarura dhe të barabarta, në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

Dokumenti për Kosovën, që është hartuar pas 14 muajsh negociatash dhe bisedimesh intensive në mes të Kosovës dhe Serbisë, përmban kompromise të dhimbshme që delegacioni



i Kosovës ka bërë me qëllim të akomodimit sa më të plotë të komuniteteve joshumicë në Kosovë, në rend të parë të komunitetit serb. Siç mund të kenë dëgjuar shpesh këto ditë, mbi dy të tretat të dokumentit të Presidentit Ahtisaari lidhen me dispozitat që garantojnë një përfaqësim dhe pjesëmarrje efektive të komunitetit serb në jetën politike, ekonomike dhe institucionale në Kosovë.

Me popullsi mbi nëntëdhjetë përqind shqiptare, Kosova u njeh pakicave të veta një nivel të drejtash që s'i kanë pakicat në vende të tjera në Evropën Juglindore. Serbishtja e pesë përqindëshit të popullsisë është gjuhë me status të barabartë zyrtarësie me shqipen e mbinën të dhjetëpërqindëshit të popullit të Kosovës. Poashtu, gjuhët e pakicave të tjera, si turqishtja, boshnjakishtja dhe gjuha rome, marrin status të gjuhës në përdorim zyrtar në komunat ku ata përbëjnë 5-6 përqind të popullsisë.

Serbët dhe pakicat e tjera marrin me këtë pako të statusit të

Kosovës të drejta dhe garanca që sigurojnë përfaqësimin e tyre politik, apo thënë më saktë mbipërfaqësimin politik, por edhe të drejta për vetëqeverisje në rrafshin lokal që pakicat e tjera në këtë pjesë të Evropës mund t'ua kenë lakmi. Ne ua garantojmë këto të drejta, sepse ne duam ta ndërtojmë fatin dhe mirëqenien tonë mbi lumturinë tonë e të bashkëqytetarëve tanë, mbi lumturinë e përbashkët, e jo mbi fatkeqësinë e kujtdo.

Në takimin e 10 marsit në Vjenë, delegacioni i Kosovës e ka deklaruar qartë përkrahjen për Planin e Ahtisarit – le të më lejohet ta quaj kështu këtë pako, mbasi që është bërë emërtim popullor.

Po e theksoj edhe një herë se kompromiset e dhimbshme dhe të gjitha koncesionet që i kemi bërë gjatë këtij procesi negociator kanë synuar të adresojnë shqetësimet dhe kërkesat e pakicave, në rend të parë të komunitetit serb. Më duhet ta them se, edhe pse kemi shprehur drojë se disa zgjidhje të ofruara në këtë pako mund

ta sfidojnë funksionalitetin strukturore të shtetit tonë, jemi pajtuar me to për të mos lënë asnjë hapësirë për pakënaqësi të komuniteti serb.

Ne e kemi mirëpritur këtë plan dhe zotohemi se do ta zbatojmë si një dokument që ofron bazë të mirë si pako përbërëse për shtetin e pavarur të Kosovës, ku shumica shqiptare dhe pakicat marrin përgjegjësitë e plota për ta qeverisur vendin, duke respektuar nevojat ekzistenciale dhe sensibilitetet kulturore e etnike të njëri-tjetrit.

Ne kemi besim të plotë se Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do të marrë qëndrim meritore në përkrahje të planit të Presidentit Ahtisaari. Ky plan përmban të gjitha dispozitat e nevojshme për ta bërë Kosovën shtet të pavarur dhe funksional. I bëjmë thirrje Këshillit të Sigurimit, këtij organi të lartë ekzekutiv të OKB-së, që sa më shpejt që të jetë e mundshme të marrë vendimin me të cilin hapet rruga për përcaktimin definitiv të statusit të Kosovës, pas tetë vjetësh nën administrimin e përkohshëm të OKB-së.

Kjo është Kosova e ardhme, shtet modern, i cili realizohet pas një historie të gjatë rezistence ndaj okupimit të huaj, duke pasë kaluar edhe stuhitë e luftës dhe përpjekjet e mëdha për rimëkëmbje fizike e shpirtërore nga viti 1999 e këndej.

Ne kemi gëzuar ndihmën e pakursyer të botës demokratike në vitet e pasluftës. Këto ndihma na kanë mundësuar që të tejkalojmë problemet emergjente e të konsolidimit si pasojë e luftës dhe dezinvestimit

shumëvjeçar në Kosovë. U jemi mirënjohës të gjitha vendeve dhe institucioneve ndërkombëtare që nakanë ndihmuar në rindërtimin e Kosovës pas luftës. Posaçërisht, i jemi mirënjohës UNMIK-ut, mision që tashmë është afër përfundimit të suksesshëm.

Duhet theksuar se gjatë kësaj periudhe, pas ndërhyrjes së trupave të NATO-s dhe vendosjes së misionit të OKB-së në Kosovë, kanë ndodhur procese të rëndësishme demokratike dhe zhvillimore. Mbi bazë të zgjedhjeve të lira e demokratike, në Kosovë janë ndërtuar institucione të qëndrueshme në nivel lokal dhe qendror, të cilat janë dëshmuar me funksionalitetin e tyre. Sukses i këtyre institucioneve është rimëkëmbja ekonomike e Kosovës dhe fillimi i transformimit rrënjësor të kësaj ekonomie mbi baza të ekonomisë së lirë të tregut. Është krijuar një infrastrukturë bashkëkohore ligjore për të gjitha fushat. Kosova ka krijuar një sistem të qëndrueshëm bankar dhe buxhetor dhe zhvillon një proces të suksesshëm të privatizimit. Sido që të jetë, në mungesë qartësie të statusit, ekonomia e Kosovës nuk ka mundur të zhvillohet në potencialin e vet të plotë, dukë mos pasur mundësinë për qasje në institucionet financiare ndërkombëtare dhe për partneritet edhe më të suksesshëm me investitorët e jashtëm.

Sovraniteti është për shumë arsye parakusht për qëndrueshmëri ekonomike të vendit tonë: për investime afatgjata që sigurojnë rritje ekonomike të vendit, duke shfrytëzuar resurset e mëdha natyrore të Kosovës (linjtitin, mineralet, tokën bujqësore), por edhe resursin njerëzor – një popullsi të re e të arsimuar mirë. Thënë shkurt, sovraniteti i

mundëson Kosovës prosperitet ekonomik në botën gjithnjë e më të ndërvarur në trendet e globalizimit.

Gjatë këtyre viteve, Kosova ka përmbushur një vistër të gjerë të standardeve, të njohura si Standarde për Kosovën, të cilat kanë përmirësuar cilësinë e jetës, demokracinë, si dhe të drejtat dhe liritë e qytetarëve të saj.

Tash është koha që Kosova, me identitetin e vet të veçantë etnik, gjeografik, historik, e juridik, me strukturat demokratike përfaqësuese që ka krijuar, edhe me ndihmën e UNMIK-ut, të njihet si shtet i pavarur dhe sovran. Kosova është rast sui generis në kuptimin e plotë të fjalës. Kjo gjë pranohet sot pothuajse prej të gjithëve. Me Kosovën shtet ne marrim përgjegjësitë dhe obligimet që i takojnë vendit që synon të bëhet pjesë e sistemit ndërkombëtar.

Edhe pas pavarësisht, Kosova do të gëzojë për një kohë një prani të ndjeshme ndërkombëtare, civile dhe ushtarake, të cilën e kemi ftuar ne, autoritetet legjitime të Kosovës. Kjo prani do të jetë aty për të na ndihmuar në rrugën tonë të integritit në familjen euro-atlantike -- shtëpinë e vlerave që kemi të përbashkët me kombet e lira e demokratike të kësaj pjese të globit tokësor.

Ne i kemi ndarë rrugët me Serbinë në vitet e nëntëdhjeta të shekullit XX. Elita politike e Kosovës synonte vlerat moderne evropiane, ndërsa elita politike e Serbisë ishte kthyer në mitet e shekullit XIX dhe, përmes kësaj, të një mesjetarizim i hapësirës sonë jetësore.

Tani është koha që Kosova dhe Serbia, si vende të pavarura, të shkojnë rrugës së integritimit në strukturat e Unionit Evropian dhe në NATO. Kjo është e

ardhmja e përbashkët e të gjitha vendeve të rajonit. Popujt tanë duan të udhëtojnë lirshëm, të gëzojnë liritë dhe mundësitë që i gëzojnë ata që tashmë janë pjesë e Unionit Evropian. Ne mëtojmë të jemi pjesë e vlerave demokratike dhe normave ligjore që mishëron Unioni Evropian, dhe jemi të përkushtuar që të bëjmë punë praktike që t'i inkorporojmë ato në ligjet dhe institucionet tona. Ne e dimë se ky është një udhëtim i gjatë dhe i vështirë që kërkon punë të madhe, por jemi të përkushtuar të shkojmë kësaj rruge. Këtë ambicie duhet ta kenë të gjithë fqinjët tanë. U them të gjithë fqinjëve, pra edhe Serbisë: le të shkojmë përpara rrugës së integritimit euro-atlantike.

Dua t'ju siguroj edhe një herë se shteti i ardhshëm i Kosovës do të ofrojë gamën më të gjerë të mundshme të mbrojtjes, si kushtetuese ashtu edhe institucionale, për të siguruar sundim të ligjit dhe mbrojtje të të drejtave të të gjithëve: të shqiptarëve shumicë dërrmuese, të komunitetit serb, dhe të komuniteteve të tjera pakicë.

Pavarësimi i Kosovës dhe njohja e saj shtet sovran dhe i pavarur do të thotë paqe dhe stabilitet në të gjithë rajonin. Pavarësimi do të thotë përfundimisht zgjidhje e çështjes më të madhe të pazgjidhur në Evropën Juglindore. Pavarësia e Kosovës do të thotë hapje e rrugës për integritime euro-atlantike, jo vetëm për Kosovën por edhe për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Si shtet i pavarur, përkushtim të veçantë do ta kemi bashkëpunimin me të gjithë fqinjët tanë dhe vendet e rajonit.

Ne e kemi bërë të qartë se nuk kemi pretendime apo lakmi për territore të të tjerëve, por as nuk do të tolerojmë pretendimet

ndaj territorit tonë. Fundja, Kosova ka përkrahur fuqishëm parimet udhëheqëse të Grupit të Kontaktit nga fundi i janarit të vitit 2006.

Kosova mirëpret ditën kur do të mund të ushtrojë të drejtën për anëtarësim në të gjitha institucionet dhe organizmat ndërkombëtarë, pra edhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Më lejoni që në fund të këtij procesi të gjatë dhe kompleks, t'u shpreh falënderimet e mia, në emër të Ekipit të Unitetit dhe të popullit të Kosovës, Presidentit Ahtisaari dhe UNOSEK-ut, për punën e madhe gjatë procesit të negociatave që është kurorëzuar me atë që sot po e quajmë Plani i Presidentit Ahtisaari për definimin e statusit politik të vendit tim, Kosovës.

Ky plan krijon shansin e pazëvendësueshëm për të ardhmen e Kosovës dhe të rajonit tonë. Ky shans mund të bëhet realitet vetëm nëse procesi për definimin e statusit final mbaron me pavarësinë e Kosovës.

Në emër të popullit të Kosovës, ju falënderoj që më dhatë rastin t'ju drejtohem në këtë kohë vendimtare për Kosovën. Ne ju jemi mirënjohës për gjithë punën që keni bërë ju në Këshillin e Sigurimit dhe në Kombet e Bashkuara në përgjithësi për të ndihmuar vendin tim, që sapo kishte dalë nga një luftë shkatërrimtare e imponuar nga Serbia e Millosheviqit. Populli i Kosovës është i bindur se ju do të merrni vendimin e duhur për të krijuar një të ardhme të sigurtë dhe prosperuese për Kosovën dhe popullin e saj.

*Fjala e Presidentit të Kosovës, Fatmir Sejdiu, në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, Nju-Jork, 19 mars 2007*



## “Nuk janë shterur mundësitë për bisedime shtesë”

Fjalimi i z. Boris Tadiq, Presidentit të Republikës së Serbisë gjatë bisedimeve në Vjenë



Dokumenti i z. Ahtisaari është krejtësisht i papranueshëm për ne, ngase ka dështuar ta përsëris sovranitetin e Republikës së Serbisë mbi Kosovën dhe Metohinë, kështu që vë në pyetje integritetin territorial të vendit tonë. Një numër i klauzolave të dokumentit hap rrugën drejt pavarësisë së Kosovës dhe Metohisë dhe kjo bie në kundërshtim me disa parime thelbësore të së drejtës ndërkombëtare, që në mënyrë të qartë mbron sovranitetin dhe integritetin territorial të shteteve të njohura ndërkombëtarisht-veçanërisht, dokumentet si Karta e Kombeve të Bashkuara dhe Akti Përfundimtar i Helsinkit.

Nga koha e dorëzimit paqësor të kompetencave, në tetor të vitit 2000, Serbia ka qenë partnere e besueshme në bashkëpunimin rajonal dhe ka po të njëjtin synim si shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor: hyrjen e shpejtë në Bashkësinë Europiane. Prioritetet e qarta të politikave të jashtme të Serbisë, tendenca jonë e matur drejtë kërkimit të kompromisit dhe besimit tonë tradi-

cional në Kombet e Bashkuara, bindshëm na shpui në marrjen e qëndrimit aktiv dhe konstruktiv në bisedimet politike mbi statusin e ardhshëm të Kosovës dhe Metohisë. Në rrethanat që nuk ishin gjithëherë të favorshme, shteti ynë ka investuar përpjekje të pamasa në propozimin e zgjidhjes reale, të drejtë dhe kompromis të mundshëm për pyetjet e rëndësishme.

Kjo më së shumti mund të shihet në çështjen thelbësore të këtyre bisedimeve, çështja e statusit të Kosovës dhe Metohisë. Kompromisin, të cilin ia ofroi Serbia, komunitetit shqiptar të krahinës është shumë i gjerë, autonomi substanciale që do të garantohet ndërkombëtarisht. Serbia do ti mbaj vetëm një numër të vogël të kompetencave të radhitura siç janë: politika e jashtme, mbrojtja (sipas propozimit tonë, Kosova dhe Metohija do të jetë plotësisht e demilitarizuar), mbrojtja e trashëgimisë religjioze dhe kulturore etj. Në të njëjtën kohë, do të ripërtërihen lidhjet ekonomike ndërmjet krahinës dhe Serbisë për të mirën tonë të përbashkët. Siç e kemi pohuar disa herë gjatë negociatave të Vjenës, ne me kënaqësi do ta pranohim pjesëmarrjen e shqiptarëve të Kosovës dhe Metohisë në institucionet kombëtare të Serbisë, nëse ata zgjedhin ta bëjnë këtë- natyrisht me disa ndryshime të marrëdhënieve ekzistuese ndërmjet kompetencave kombëtare dhe krahinore.

Do të doja të theksoja, që zgjidhja tillë e statusit të ardhshëm të Kosovës dhe Metohisë është në përputhje të plotë me të drejtën

ndërkombëtare dhe standardet bashkëkohore europiane mbi të drejtat e pakicave. Fatkeqësisht, i Dërguari Special nuk i ka kushtuar vëmendje të mjaftueshme propozimit tonë, në vend të kësaj ka zgjedhur të propozoj zgjidhjen, miratimi i së cilës mund të qoj në destabilizim afatgjatë në rajon dhe më gjerë.

Po ndodhi që të pranohet propozimi i Ahtisaari-t, kjo do të ishte hera e parë në historinë bashkëkohore, që territori t'i merret një shteti demokratik dhe paqësor në mënyrë që ti kënaq aspiratat e një grupi të caktuar etnik, i cili tanimë e ka shtetinkomb të tij.

Serbia ka qenë aktive dhe konstruktive në adresimin e të gjitha këtyre çështjeve në negociatat e Vjenës, veçanërisht në çështjet rreth decentralizimit, mbrojtjes së trashëgimisë religjioze dhe kulturore serbe, çështjeve pronësore dhe financiare. Jam i kënaqur që është arritur përparim në një çështje, gjegjësisht çështjen e pjesës së Kosovës e Metohisë në borxhin e jashtëm të vendit tonë. Megjithatë, propozimet tjera janë larg nga kompromisi i baraspeshuar dhe qëndrueshëm, që do të mund të pranohej pas më shumë se një vit negociatash.

Më duhet të tërheq vëmendjen për faktin që të gjitha propozimet tona- nëse ato kishin të bëjnë me çështjen e statusit ose çështjet tjera- gjithmonë ranë në kundërshtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Parimet Udhëzuese të Grupit të Kontaktit, që do të thotë

se dokumentet e Bashkësisë ndërkombëtare parashikonin një lloj kornize në kuadër të së cilës, do të zinin vend bisedimet mbi statusin e ardhshëm dhe të cilave vetë i Dërguari Special i është referuar në shumë raste. Analizat e kujdesshme të negociatave të Vjenës tregojnë qartë, që mu këto dokumente do të mund të shfrytëzoheshin për të na quar shumë afër zgjidhjes, në krahasim me atë se ku qëndrojmë tani. Në kuptimin që, nuk do të ishte e saktë të thuhet që negociatat e Vjenës ishin negociatat e fundit në radhën e mundësive të humbura. Megjithatë, tani është e rëndësishme të shihet çfarë mund të bëhet, ashtu që faza e tanishme e procesit negociator të jetë e suksesshme, në mënyrë që të hapë mundësinë drejt një zgjidhjeje kompromisi, e pranueshme për të dyja palët.

Kur propozimi i të Dërguarit Special t'i dorëzohet Nju Jorkut, atëherë do të zënë vend konsultimet në kuadër të Këshillit të Sigurimit. Grupi i Kontaktit dhe vendet anëtare të Bashkësisë Europiane tanimë e kanë të njohur propozimin dhe presim që së shpejti të zë vend një debat serioz për dokumentin e Ahtisaari-t. Serbia, e cila nuk është anëtare e Këshillit të Sigurimit, nuk do të marrë pjesë drejtpërsëdrejti në këto konsultime dhe debate, por mbetet e gatshme që të angazhohet në mënyrë konstruktive në bisedime shtesë- që sipas mendimit tonë, kjo mundësi akoma nuk është shterur.



# E ardhmja e Kosovës

Agim Çeku, Kryeministër i Kosovës



Kemi hyrë në fazën e fundit të procesit diplomatik, i cili jam i bindur do të sjellë pavarësinë e Kosovës. Përqendrimi ynë politik tani është në drejtim të Nju Jorkut dhe procesit të Këshillit të Sigurimit. Unë jam i bindur se në fund, Rezoluta e Këshillit të Sigurimit e cila do të miratojë propozimin e Ahtisaarit për Kosovën – e cila, në të vërtetë, përkrahë pranimin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së të rekomandimit për pavarësi – do të miratohet, duke na ofruar mundësinë që përqendrimin tonë ta drejtojmë tek Brukseli dhe BE-ja. Synimi ynë përfundimtar duhet të jetë Kosova e pavarur, demokratike, prosperuese dhe e integruar në BE. Unë mendoj që shumica e Kosovareve janë të vetëdijshëm se statusi nuk do të sjellë lehtësime ekonomike dhe prosperitet të menjëhershëm. Një gjë e tillë kërkon planifikim, durim dhe përpjekje afatgjate. Por pavarësia është parakusht për një përparim të tillë dhe është hapi i parë drejt ardhmërisë Evropiane të Kosovës. Ekonomia dhe Evropa janë baza e stabilitetit tonë të ardhshëm.

Ne jemi duke u bërë të pavarur në mënyrë që të mund të bëhemi të ndërvarur. Ky është paradoksi i BE-së bashkëkohore. Kosova ka nevojë për një perspektivë

Evropiane meqë kjo është mënyra e vetme reale për të mbështetur rritjen ekonomike të vendit, për të nxitur prosperitetin tonë social dhe për të ruajtur demokracinë tonë. Konfirmimi se Kosova është në shteg të BE-së do të jetë një indikatorë shtesë për pakicat tona dhe fqinjët tanë se pavarësia e Kosovës është një zhvillim jashtëzakonisht pozitiv.

Skeptikët nuk duhet të ndihen të brengosur: Kosova e pavarur është opsioni më i mirë për stabilitetin e vonuar rajonal. Zgjidhja e statusit do të na mundësojë përparim ekonomik dhe demokratik, përderisa Serbia më në fund do të jetë në gjendje t'i përqendrojë energjitë e saja drejt Brukselit. E ardhmja është në Evropë. Tani sytë e të gjithëve janë drejtuar kah Rusia, por unë mendoj se Rusia në fund mbështesë vlerësimin tonë – se Kosova e pavarur është opsioni më i mirë për stabilitetin e vonuar rajonal, i cili përfundimisht është në interes edhe të Rusisë.

Rajoni duhet të lëvizë drejt BE-së bashkërisht, që do të thotë se ne duhet të nxisim bashkëpunimin rajonal, të mbështesim zhvillimin tonë ekonomike dhe të fuqizojmë institucionet tona politike. Kosova mund të ketë të ardhme të ndritshme ekonomike nëse tregu jonë është tërësisht i integruar dhe i funksionueshëm me fqinjët tanë. Furnizimi dhe kërkesa duhet të plotësohen dhe të kontrollohen në mënyrë rajonale dhe eventualisht edhe globale, por jo në mënyrë lokale. Strategjia zhvillimore e Kosovës nuk ka të bëjë me ndërtimin e një ishulli në mes të Evropës Juglindore.

Potenciali jonë i burimeve njerëzore është i lartë: popullata e Kosovës është e re dhe në rritje e sipër. Me një arsim të duhur,

Kosovarët mund të luajnë një rol të rëndësishëm duke ndihmuar boshllëqet e ofsetit ekonomik të BE-së në furnizim me fuqi punëtore. Popullata e vjetruar e BE-së dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik në Evropë, është duke krijuar shumë pasiguri për disa vende të BE-së. Zgjidhjet që sot kërkohen nga disa politikanë të BE-së janë të vështira – rritja e moshës së pensionimit apo rreziku i ikjes së korporatave në drejtim të Azisë ku stimulimet e tregut dhe kushtet e fuqisë punëtore janë më fleksibile.

Por, në mënyrë që popullata e Kosovës të ndihmojë në zhvillimin e punës në Evropë, ne kemi nevojë të madhe për modifikim të politikave të vizave të BE-së. Që nga zgjerimi në drejtim të Lindjes, BE-ja ka shtuar afro 2.3 milion vende të reja të punës në treg. Kjo është mbresëlënëse, madje është edhe më e lartë se rritja e tregut të punës në ShBA. Një qasje ku një madhësi i përshtatet të gjithëve, në kuptim të zbatimit të politikës së vizave drejt këtij rajoni është e pamjaftueshme dhe nuk do të zgjidhë shqetësimet kryesore të Evropës – që kuptohet se janë të drejtuara në aspekte të sigurisë. Në të njëjtën kohë, është vështirë që ne në rajon të predikojmë ëndrrën Evropiane para qytetarëve tonë nëse atyre në mënyrë sistematike u mohohet qasja në të.

Për ne, momenti Evropian ka ardhur. Kritikkat ndaj Evropës lidhur me menaxhimin e kolapsit të Jugosllavisë janë tejkualuar përmes qasjes gjithnjë e më të qëndrueshme dhe shtimit të ndikimit të BE-së në rajon. BE-ja mori pushtetin nga NATO-ja në Bosnje dhe në Kosovë Evropa është duke e marrë pushtetin

nga OKB-ja. Megjithatë, madje edhe para tranzicionit, BE-ja ka mundësi që të tregojë vendosmërinë dhe vizionin e saj duke mbështetur lëvizjen drejt pavarësisë së Kosovës dhe duke i ofruar botës sukses të plotë këtë vit.

Përkushtimi politik i BE-së për rajonin nuk mund të vihet në dyshim. Ai është shprehur qartas në Selanik qysh në vitin 2003. Ndoshta disa gjëra të caktuara do të mund të lëvizin më shpejt. Nuk ka arsye që Maqedonia të mos fitojë një datë fillestare për nisjen e negociatave me BE-në për anëtarësim. Maqedonia nuk do të bëhet anëtare e BE-së brenda natës, por duke i dhënë Shkupit një datë për fillimin e negociatave do të rritet imazhi i Evropës në rajon dhe kjo do të na ndihmonte në sfidën ndaj euro-skeptikëve dhe nacionalistëve mendjengushtë.

Zhvillimi i institucioneve funksionale dhe të efektshme është një tjetër prioritet i madh i Kosovës. Unë e shoh rolin e OSBE-së si qenësor, duke na ndihmuar në arritjen përsoshmërisë së madhe në sistemin tonë ligjor. Besimi i investitorëve varet nga sundimi i ligjit dhe Kosova nuk duhet të ketë iluzione mbi efektin që do të ketë vetëm pavarësia në investime. Aktiviteti i vërtetë ekonomik në Kosovë do të arrijë vetëm pasi të kemi krijuar një sistem ligjor funksional.

Unë jam optimist. Kosova është duke ecur mbarë në njohjen e pavarësisë së saj si shtet. Gjithashtu, ngadalë por sigurt, jemi duke fuqizuar lidhjet tona me Evropën. Pavarësia do të ndihmojë Kosovën – dhe rajonin – që arrijë më shpejt në Evropë dhe të sjell një siguri dhe stabilitet të ri në vetë Evropën.

# Kosova meriton t'i qartësohet plotësisht e ardhmja e saj

Joachim Rucker, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP) për Kosovën

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP) për Kosovën Joachim Rucker, në një sesion të mbyllur të Këshillit të Sigurimit të OKB-së më 19 Mars 2007 dha një pasqyrim të fundit rreth përparimeve të bëra në Kosovë. Kryetari i Kosovës Fatmir Sejdiu ka shoqëruar PSSP-në në Këshillin e Sigurimit.

“Muajt e fundit kanë paraqesin një periudhë dinamike të politikës në Kosovë,” tha z. Rucker. Ai vlerësoi se propozimi i të Dërguarit Special të OKB-së për statusin e Kosovës i prezantuar me 2 shkurt “është pritur mirë në përgjithësi” nga shqiptarët e Kosovës si dhe Ekipi Negociator i Kosovës. “Që atëherë në fokus ishin dispozitat e këtij propozimi mbi decentralizimin dhe garantimi i kompetencave shtesë në autoritetet e ardhshme lokale,” tha ai dhe shtoi: “Në përgjithësi, pakoja e Ahtisarit në nga shqiptarët e Kosovës shihet si një kompromis i vështirë por i pranueshëm për akomodimin e pakicës serbe të Kosovës”

Në anën tjetër reagimi i serbëve të Kosovës ndaj propozimit ka qenë kryesisht negativ, i ngjashëm me vështrimet e shprehura nga udhëheqësitë politike në Beograd, në mospërfilljen e dispozitave gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e të drejtave të serbëve të Kosovës, interesat dhe identitetin e tyre, siç janë decentralizimi dhe zonat e mbrojtura të vendeve fetare dhe ato të trashëgimisë kulturore.

“Me sukses, udhëheqësit politik po intensifikojnë përpjekjet e tyre për t'u takuar me serbët e Kosovës dhe për t'i siguruar ata që propozimi për statusin përmbanë një sërë rregullimesh të hartuara me kujdes për të



mbrojtur të drejtat, interesat dhe identitetin e tyre në mënyrë të plotë,” theksoi Rucker. “Udhëheqësit e shqiptarëve të Kosovës nga Ekipi Negociator i Prishtinës që në përbërje ka edhe udhëheqës të opozitës, kanë bërë përpjekje të dukshme për të inkurajuar popullatën të ruajë durimin, dhe kanë bërë thirrje të pareshtura për ruajtjen e qetësisë besimit në procesin e statusit” shtoi ai.

PSSP shprehu shqetësimet e tij mbi efektin potencial të destabilizimit nga çfarëdo shtyrje të mundshme të procesit e cila njëkohësisht do të pamundësonte gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme.

Z. Rucker vlerësoi përkushtimin e pareshtur të institucioneve Kosovare në përmbushjen e standardeve në shume fusha me prioritet, duke përfshirë fushat me rëndësi vitale për pakicat. “Vullneti politik i IPVQ-ve për zbatimin e reformave mbetet i

qëndrueshëm, dhe vendosja e këtyre reformave në kontekst të integritimit në Bashkimin Evropian ka qenë një shtysë e fuqishme për përparim të mëtejshëm,” tha ai.

Mirëpo PSSP përmendi që në shumë raste përpjekjet për zbatim nuk kanë rezultuar me përmirësime të kushteve të jetesës për serbët e Kosovës. Arsyeya kryesore për këtë është mungesa e vullnetit të shumë serbëve të Kosovës për të marrë pjesë në institucione apo për të pranuar mundësitë e ofruara nga Qeveria dhe kuvendet komunale.

“Shumë shpesh, mospjesëmarrja e tyre në institucione duket të ketë lidhje me qëndrimet e Beogradit, i cili ka vazhduar të kërcënojë shërbyesitë civilë serbë në Kosovë me ndërprerje të pagave të tyre nëse ata vazhdojnë të qëndrojnë në listën e legjitimitet të pagave të IPVQ-ve,” tha z. Rucker, “Beogradi po

vazhdon me deklaratat të cilat e dekurajojnë kthimin e serbëve dhe me politizimin e incidenteve të sigurisë, gjë që krijon një klimë të paarsyeshme të frikës dhe demonstroi mungesë të vazhdueshme të respektimit ndaj Rezolutës 1244 të KS të OKB-së. Edhe një herë i bëj thirrje përfaqësuesve të Qeverisë së Serbisë që të mbështesin pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës në IPVQ.”

PSSP theksoi se të gjithë që jetojnë në Kosovë kanë të drejtë t'u qartësohet e ardhmja e tyre, në mënyrë që të jenë të sigurt se e dinë se cili ku gjenden dhe cili është pozicioni i tyre sa i përket institucioneve të cilat e organizojnë shoqërinë. “Serbët e Kosovës kanë nevojë ta kenë të qartë këtë në mënyrë që të përmbledhin fuqinë e tyre për të marrë vendimet që donë të marrin: të pranojnë dorën e zgjatur nga institucionet e Kosovës dhe të bëhen pjesë e shoqërisë Kosovare” tha ai, “Shqiptarët e Kosovës dhe Komunitetet tjera në Kosovë poashtu duhet të kenë qartësi rreth statusit për të qenë të sigurtë pas gati tetë viteve të administratës ndërkombëtare, që e ardhmja që po e ndërtojnë ata dhe udhëheqësit e tyre është e përhershme dhe e qëndrueshme.”

Z. Rucker konkludoi se mbajtja e kohezionit të procesit të statusit do t'i mundësojë bashkësisë ndërkombëtare “që të përfitojë shumë e shumë mundësi dhe raste të tjera”. Ai shprehu besimin se “angazhimi i vazhdueshëm i Këshillit të Sigurimit do të sigurojë që kjo mundësi për të stabilizuar tërë rajonin dhe për të hequr pengesat drejt rrugëtimit të tij në Evropë nuk do të humbet”.

# Tre skenarë të zhvillimeve për Kosovën

*Veton Surroi, anëtar i Ekipit Negociator të Kosovës, kryetar i partisë ORA*

Me 10 Mars të këtij viti apo më shumë se dhjetë ditë më parë kemi përfunduar raundin e fundit të konsultimeve apo negociatave në procesin të cilin e udhëhoqi presidenti Ahtisaari. Në fakt, nuk ishte vetëm raundi i fundit i negociatave për Kosovën para se të shkojë në Këshillin e Sigurimit por në një mënyrë simbolike ishte raundi i fundit i negociatave për shpërbërjen e ish Jugosllavisë. Ishte raundi i fundit i negociatave, i një procesi të gjatë, i cili ka filluar me planin e Keringtonit në të '90 e hershme dhe i cili vazhdojë nëpër Dejton dhe Rambouillet dhe proceset tjera të mëvonshme.

Dhe në fakt nuk ishte ditë simbolike vetëm se shënonte përfundimin e një procesi të gjatë dhe të dhunshëm të dezintegrimit që i ka paraprirë këtyre negociatave, por ishte simbolik edhe për faktin se ndodhi në përvjetorin e parë të vdekjes së Slobodan Milosevicit, njeriut i cili ishte i lidhur ngushtë me procesin e dezintegrimin të ish-Jugosllavisë.

Në fakt, atë ditë mendoja duke kaluar kohën në dhomën e bisedimeve se ishte ditë simbolike e dhënies fund të padrejtësive, sepse përvjetori i vdekjes së Miloshevicit nuk ka qenë vetëm padrejtësi e lidhur me emrin e tij por ka qenë edhe një padrejtësi tjetër e cila i pamundësoi që të jetojë verdiktin e merituar nga gjykata e Hagës, për krimet të cilat ishte fajtor.

Poashtu ishte fund i padrejtësisë në kuptimin se i tërë procesi i dhunshëm i dezintegrimin të ish-Jugosllavisë



ka shkaktuar ndryshime të shumta në jetët e njerëzve. Dhe nëse shikojmë prapa, e shohim se ka qenë nga ato proceset që ka mundur të shkojë në të dyja kahet por i cili shkojë në anën e gabuar duke ndryshuar përgjithmonë jetët e shumë njerëzve, në formë dhunshme.

Dhe gjate bisedimeve, në këto negociata, kjo është një kornizë të cilën duhet ta kemi gjithnjë parasysh sepse është e lidhur me mënyrën në të cilat jetët e qytetarëve ndruan dramatikisht. Kemi përfunduar në këto negociata për faktin se shumë njerëz kishin pësuar aq shumë, për të mbërri në këtë moment, në të cilin jetët e tyre

do të duhej të ndërronin për të mirë.

Dhe duke qenë këtu në Bankë, mendoj se fjala kyçe e domosdoshme në këtë kufij të ndryshimeve është "besimi". Kjo fjalë kyçe që ka të bëjë me veprimtarinë bankare njëkohësisht ka të beje edhe me procesin negociator, pra ka të bëjë me atë se si të krijohet besimi në të ardhmen, të cilën do të jetojmë, si të krijohen urat e mirëbesimit në mënyrë që kjo e ardhme të realizohet.

Ajo që jemi përpjekur të bëjmë në 18 muajt e fundit të negociatave është që të merremi me dy komponentët themelore të atij besimi. E para ishte sfida se si të krijohet besimi

në mes shumicës dhe komuniteteve pakicë në Kosovë dhe e dyta si të krijohet besimi në mes Kosovës dhe Bashkësisë Ndërkombëtare.

E para, ka të bëjë me mënyrë se si të krijohen identitetet e këtyre komuniteteve në të ardhmen sepse kur jetoni në një situatë demografike ku ka një mazhorancë 90 përqindëshe dhe 10 % minoritete dhe kësaj i shtohet një e kaluar e dhunshme është e qartë se ekziston frika e minoriteteve që identiteti i tyre, e ardhmja e tyre, do të eliminohet nga ajo e shumicës. Dhe kjo është gjëja të cilën kemi dashur ta ndryshojmë, kemi dashur të krijojmë të ardhme të përbashkët, dhe për këtë arsye i kemi kaluar 18 muajt e fundit duke diskutuar intensivisht rregullimin e këtyre çështjeve.

Çështja e dytë që nuk është diskutuar aq shumë, por gjithsesi ka qenë prezente si koncept në mendjen tonë, është se si të krijojmë vlerat e përbashkëta me bashkësinë ndërkombëtare për atë që është vendbanimi (habitati) jonë i natyrshëm, dhe vendbanimi i jonë i natyrshëm është Bashkimi Evropian, pra vlerat e Bashkimit Evropian. Dhe janë, në fakt, standardet dhe vlerat ndërkombëtare qeverisëse të cilat po mundohemi ti ruajmë dhe ti zhvillojmë më tutje.

E ardhmja e afërt e Kosovës, e cila në fakt do të na përcjellë – sepse siç thuhet në traditën islame, në varësi se si do të jetë dita e parë e ramazanit ashtu do të jetë edhe e fundit, pra me atë mot do të vijë Bajrami - edhe negociatat në të cilat do të duhet të kalojmë muajve



të ardhshëm me siguri do të diktojnë të ardhmen, ngjashëm me këtë punën e Ramazanit. Nëse shkojmë rrugës së drejtë procesi do të zhvillohet në të njëjtën mënyrë por nëse shkojmë rrugës problematike atëherë me gjasë do të na shpie tek një proces problematik në aspekt të statusi të ardhshëm.

Janë tri skenarë të mundshëm të zhvillimeve se si do të rezultojë procesi i statusit të Kosovës, pra se si do të rezultojë edhe e ardhmja jonë.

Skenari i parë i mundshëm është që plani i Ahtisaarit të pranohet, në formë eksplicite, nga të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Sigurimit. Kjo do të ishte një rezolutë ku të gjitha shtetet do të thonin “z. Ahtisaari ti ke bërë një punë të shkëlqyeshme, ne pranojmë pakon tuaj dhe njëkohësisht rekomandojmë që Kosova të bëhet shtet i pavarur i cili implementon në tërësi mbrojtjen e minoriteteve sipas planit tuaj. Nga pikëvështrimi i tanishëm ky skenar nuk duket me gjasë të mëdha.

Skenari i dytë është ai i kontraktave, gjatë javëve dhe muajve që vijnë, ku një grup i fortë shtetesh anëtare do ta përkrahin planin e Ahtisaarit ndërsa një grup tjetër, i udhëhequr nga Rusia, do ta kundërshtonte jo vetëm planin por procesin si tërësi dhe do të kërkonte një proces të ri të nisur nga fillimi. Skenari i tillë do të rezultonte me situatë konfliktuoze apo ndarje të qartë në mes shteteve, të cilat përkrahin procesin dhe punën e bere deri tani, dhe Rusisë, apo edhe shteteve tjera të mundshme, në anën tjetër. Kjo do të krijonte rrethana të reja në Bashkësinë Ndërkombëtare sepse për herë të parë Serbia do të pajisej me potencial nuklear, sepse fuqia nukleare krijon fuqi Veto-je

ne Këshillin e Sigurimit dhe në këtë aspekt Serbia përmes Rusisë do të vinte Veto-n në një rezolutë të mundshme.

Skenari i tretë është ai, në të cilin anëtarët e Këshillit të Sigurimit në formë implicite do t'i jepnin përkrahje planit të z. Ahtisaarit dhe do të lente mundësinë që shtetet individualisht të deklarohen për atë se si duan ta shohin Kosovën në të ardhmen, duke u mbështetur në rekomandimet e pakos apo në pakon si tërësi.

Dhe ky skenar, nga perspektiva e sotme, duket si më i mundshëm sesa dy skenarët paraprak. Kjo do të thotë se do ecim nëpër një vijë të hollë për ta përcaktuar statusin e ardhshëm të Kosovës. Ky është një përfundim i paprecedent për sa i përket statusit andaj edhe i tërë procesi do të shkojë në formë paprecedente. Dhe fjala “paprecedent” po bëhet fjala e dytë kyçe sepse po bëjmë gjëra të cilat nuk kanë ndodhur më herët. Rezoluta 1244 ishte e paprecedencë, Misioni dhe mandati i UN në Kosovë ishte i paprecedencë dhe poashtu i kemi dy kategori të paprecedencë të etabllimit të marrëdhënieve përbrenda shtetit.

E para është marrëdhënia e re e paraparë me pakon e Ahtisaarit në mes të shumicës dhe pakicës. Dhe këtu me lejoni t'ju japë disa ilustrime se si mund të duken gjërat në të ardhmen. Oferta e pare, në të cilën jemi thellësisht të bindur, është siguri i sa më shumë të drejta që është e mundur për komunitetet. Dhe në këtë aspekt kemi bërë rrugë të jashtëzakonshme. Minoriteti Turk në Kosovë paraqet 0.8 % të popullatës në Kosovë, por kemi njohur të drejtën e tyre për përdorim zyrtar të gjuhës turke në komunat

ku jeton ky komunitet. Kemi për herë të parë në një dokument ndërkombëtarë, të kësaj natyre, njohjen e gjuhës Rome si gjuhë të përdorimit zyrtar në komunat ku jetojnë romët. Ky komunitet është komunitet i ndëshkuar, jo vetëm në Kosovë por në tërë Evropën, prandaj edhe pozita e tyre sot është rezultat i një racizmi evropian nga e kaluara, te cilin fatkeqësisht e kemi ndarë se bashku.

Edhe pse komuniteti serb paraqet vetëm 5 % të popullatës kemi pranuar të drejtën që ky komunitet të përfaqësohet me më shumë se 10% në parlamentin e Kosovës. Dhe në fakt të gjitha komunitetet do të kenë një të drejtë të quajtur “klauzola e interesave vitale”, e cila do të thotë se nuk mund të ketë ndryshime ligjore në çështjet me interes për komunitetet pa aprovimin procedural nga ana e tyre. Dhe kjo së bashku me asimetrinë e krijuar në komunat të banuara me serb, të cilat do të kenë disa të drejta shtesë në krahasim me komunat tjera, krijon një situatë sui generis, një situatë të paprecedent, por e cila brenda një kornize të shtetit të pavarur të Kosovës besojmë se mund të funksionojë.

E dyta, është dimensionin e ri i përfshirjes dhe prezencës së BE-së në Kosovë, të cilin ata nuk dëshirojnë ta quajnë mision por në fakt është i tillë. BE-ja do të jetë, nëse më lejohet ta përdorë analogjinë, Coca Cola Light në krahasim me misionin në Bosnje, ndoshta edhe tepër “Light”, por gjithsesi do të paraqesë ndryshim të madh nga ajo që kemi pas deri tash. Dhe ky është një relacion krejtësisht i ri dhe i pa hulumtuar, jo vetëm për Bashkimin Evropian por edhe për autoritetet në Kosovë.

Elementi i tretë i cili do të diktojë në masë të madhe të ardhmen tonë është mënyra se si do të silllet Serbia sepse edhe pse me vullnetin tonë do të kemi mundësi të ndërrojmë politikat tona është e pamundur të ndërrojmë gjeografinë dhe Serbia ne të ardhmen do të jetë aty ku është tani. Serbia e sotme është një vend të cilin nuk e shohim me një energji pozitive. Dhe mund të ndiejmë se si, gjatë javëve dhe muajve që vijnë, do të ndërliken zhvillimet në Kosovë me atë se si do të pranohet pakoja e z. Ahtisaari në Serbi. Nëse Serbia tenton të blloktojë apo të kundërshtojë apo tenton që aktivisht të influencojë kundërshtime ndaj pakos do të kemi zhvillime negative serioze përbrenda marrëdhënieve tona ndëretnike. Në të kundërtën, nëse Serbia adopton një qasje pozitive e cila do të pranonte dhe ftonte në implementimin e pakos së Ahtisaarit, për sa i përket të drejtave të komuniteteve, me siguri do të kishim një situatë shumë më të mirë. Çka do të ndodhë, në fakt, është një debat i nxehtë brenda komunitetit serb në Kosovë për çështjen e identitetit të serbëve të Kosovës. Çështja se a do të përpiqen serbët e Kosovës të rikthejnë, jo vetëm identitetin por edhe rolin e tyre në të ardhmen, apo do të mbesin vetëm pjesë e një politike të udhëhequr nga Beogradi është jo vetëm debat intelektual por do të thojë edhe ekzistenciale, i cili po zhvillohet përbrenda komunitetit serb.

Çështja e katërt është se si do të jetë në gjendje prezencë e ardhshme ndërkombëtare ti rezistojë çokollatës, pra si do ti rezistojë fuqive që do ti ketë. Sa do të jenë në gjendje që mos t'i shfrytëzoj fuqitë të

ciat i ka në bazë të mandatit. Dhe këto fuqi të mëdha janë tepër të cytëse apo sfiduese. Rezistenca e përdorimit të fuqisë në fakt duhet të zhvillohet së bashku një sistem llogaridhënës në Kosovë. Atë që kemi pas si problem gjatë 8 viteve të kaluara është se prania e rëndë ndërkombëtare në mënyrën e vet ka privuar krijimin e sistemit të llogaridhënies dhe rrjedhimisht edhe të një sistemi demokratik, ku Qeveria e Kosovës i jep llogari elektoratit kosovar. Dhe kjo është sfida edhe për autoritete kosovare, pra si të mënjanohet rruga e lehtë e fajësimit të bashkësisë ndërkombëtare për çdo paafësi apo mospasjes, gjë e cila ka qenë shumë e lehtë për tu bërë gjatë këtyre viteve.

Në fund, dhe me këtë do ta përfundoj, jemi të vetëdijshëm se pavarësia e Kosovës nuk do të zgjidhe të gjitha problemet. Ka pritje të mëdha në shoqërinë tonë dhe një pjesë e saj mendon se me pavarësimin e vendit me automatizëm do të zgjidhen edhe problemet tjera. Dhe është e qarte se kjo nuk do të ndodhë. Por pa pavarësi nuk do të ketë asnjë kapacitet apo mundësi për tu zgjidhur asnjë problem i vetëm. Dhe ky është dallimi për sa i përket statusit. Statusi, siç e filluam në këtë paraqitje në këtë Bankë, ka të bëjë me besimin. Pasi ta kemi fituar atë do ta kemi kapacitetin legal, politik por edhe financiarë që të ndërtojmë një shoqëri, e cila fillon nga premisat krejtësisht të ndryshme nga ato që i kemi pas deri sot.

*Shkrimi është pjesë e fjalimit të mbajtur në konferencën për Kosovën të organizuar nga ECIKS, në Vjenë, Mars 2007*

## “Delegacioni i Kosovës është angazhuar përmbylljen me sukses të procesit”

*Intervistë me z. Lutfi Haziri, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Pushtetit Lokal si dhe anëtarë i Delegacionit Negociues Kosovar*



*Z. Haziri, na thuani opinionin tuaj lidhur me procesin negociator dhe pozitën e palës kosovare në përgjithësi?*

Lutfi Haziri: Nën mandatin e veçantë të Këshillit të Sigurimi, z. Ahtisaari nga shkurti i vitit 2006 deri në

përgjegjësi të tyre që do të kenëndajpacticave. Negociatat janë përqendruar veçanërisht në fushën e decentralizimit, të drejtave të komuniteteve në nivel qendror (përfshirë parlamentin), qeverinë dhe organizatat tjera shtetërore, të drejtave në religjion dhe mbrojtje të trashëgimisë fetare dhe kulturore si dhe çështjet ekonomike. Në takimin e fundit të nivelit më të lartë u pa qartazi se bisedat kanë rezultuar me një angazhim serioz të delegacionit të Kosovës ku janë bërë edhe kompromise në interes të përmbylljes së procesit dhe të trajtimit sa ma adekuat të grupeve etnike. Në anën tjetër, roli dhe angazhimi i delegacionit të Serbisë ka pas ngritjet dhe uljet e saja, por në substancë ka qenë jo-bashkëpunues dhe tendencioz, me qëllim të mospërfundimit apo edhe shtyrjes së misionit të z. Ahtisaari. Mirëpo, tanimë dihet se krejt procesi është tek Këshilli i Sigurimit.

*A mendoni se interesat e palëve tjera janë përfshirë gjatë këtyre negociatave, p.sh. ato të komuniteteve tjera?*

mars të këtij viti, me një kalendar të ngjeshur ka trajtuar çështje që fillimisht kanë qenë të definuara si çështje teknike. Gjithë kjo rrugë ka qenë e lidhur me biseda, konsultime dhe negociata të vështira për të akomoduar interesat e shumicës shqiptare, por edhe të

Lutfi Haziri: Absolutisht, nëse i trajtojmë të gjitha fushat që janë diskutuar arrihet në përfundim që shumica shqiptare ka ofruar mbrojtje dhe të drejta kushtetuese për

të gjitha grupet etnike që janë në Kosovë dhe komunitetit serb i është ofruar një trajtim i veçantë. I tërë procesi i Vjenës ka qenë i orientuar në akomodimin e serbëve të Kosovës si pakicë sepse boshnjakët, turqit, romët, goranët dhe të tjerët që jetojnë në Kosovë këto të drejta i trajtojnë si probleme të brendshme dhe shpresojnë se do të zgjidhen në pako bashkë me shumicën shqiptare. Nëse merret parasysh vetëm një segment siç është decentralizimi, shihet qartë se në nivel të pushtetit lokal akomodimi i interesave të komunitetit serb në Kosovë është trajtuar në mënyrë serioze. Mirëpo, edhe për komunitetet tjera do të ofrohen të drejta që do të garantojnë zhvillim pozitiv në Kosovë dhe kjo do të ndodhë menjëherë pas zgjidhjes së statusit. Ne gjithashtu kemi qenë të interesuar që Kosova të ketë një demokraci funksionale, të jetë e barabartë për të gjithë qytetarët e saj dhe padyshim territori i saj të mbetet i pandashëm dhe me sistem unik kushtetues.

*A do të kishit veçuar ndonjë moment interesant dhe që ka ndodhur gjatë, të ashtuquajturave 'negociatave joformale', p.sh. gjatë drekës, pauzave të kafesë...?*

Lutfi Haziri: Në këtë fazë të procesit të zgjidhjes së statusit, më shumë do t'i kujtoja momentet e vështira të negociimit sesa ato joformale. Natyrisht që gjatë kohës së pushimeve të vogla ka pasur mundësi të komunikohet dhe të qartësohen çështjet nga prizmat e ndryshëm. Mirëpo, ia vlen të ceket se bisedat kanë qenë shumë të rënda dhe jas-

htëzakonisht të mundimshme sepse kemi pasur të bëjmë me dy kërkesa të kundërta që në substancë dallojnë diametrisht njëra me tjetrën. Sidoqoftë, unë do të veçoja rastin kur Enver Hoxhaj duke ju adresuar deputetit Randel Nojkić, emrin e tij e shtrembëron në Arandell (Nojkić, si deputet i Kuvendit të Kosovës, ka qenë i përfaqësuar në delegacionin e Serbisë). Ky lëshim shqiptimi apo gabim teknik dhe i konsideruar si joserioz i ka kushtuar deputetit Nojkić me mosvijim të bisedimeve në Vjenë.

*Z. Haziri, ju e dini se ka mjaft kërcënime dhe ide lidhur me perceptimin e procesit të decentralizimit, pasi që si shqiptarët ashtu edhe serbët e shohin këtë proces nga këndvështrimet e tyre të ndryshme dhe presin diç krejt tjetër nga ky proces. Çfarë është mendimi juaj lidhur me këtë?*

Lutfi Haziri: Ky proces prej vitit 2002 është përcjellë me dallime të mëdha në Kosovë dhe dihet se fillimisht dallimet kanë qenë në mes të shumicës shqiptare dhe administratës ndërkombëtare. Më vonë, ky dallim është bërë në mes të shumicës shqiptare dhe komunitetit etnik serb, dhe më vonë dallimet kanë dalë në mes vet faktorit politik shqiptar dhe partive politike shqiptare. Në fund, historia e këtij problemi tregoi që shumica shqiptare dhe pakicat jo-serbe arritën konsensus në parlamentin e Kosovës, dhe dallimi më pastaj u shpreh në mes të shumicës, pakicës turke, gorane, boshnjake etj dhe atë të komunitetit serb. Ky dallim ka bërë që decen-

tralizimi të kalojë në agjendën ndërkombëtare pa i dhënë mundësi që ky proces të paraqitet si pjesë e interesave të brendshme në Kosovë, përfshirë edhe ato të komunitetit serb. Ndoshta ka qenë i vonshëm edhe konsensusi dhe ka pasur qasje të gabueshme, por unë si ministër e kam trashëguar procesin dhe të tillë e kam bartur nga ish qeveria e Bajram Rexhepit dhe jam munduar ta vendosi në rrafshin konsensual në mënyrë që procesi i tillë të jetë i pranueshëm për të gjithë. Tashmë në agjendën e Vjenës, decentralizimi është i bazuar në parimet, përvojat dhe konventat evropiane dhe ajo që e bën specifike Kosovën në këtë moment është shqyrtimi i shqetësimeve të grupeve etnike në tërë këtë proces.

*A mund të na përshkruani se çfarë do të jenë marrëdhëniet ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror në të ardhmen; a do të ketë kontroll nga niveli qendror apo më mirë të themi do të jetë një lloj mbikëqyrjeje?*

Lutfi Haziri: Kompetencat komunale janë qartësuar përfundimisht. Tri kategori që janë të njohura gjithkund në Evropë, që janë një e fushë e gjerë e të drejtave të Komunave e cila nënkupton ushtrimin e detyrave sipas ligjit, por rregullimi i këtyre përgjegjësive bëhet nga vet asambletë komunale. Kategoria e dytë e të drejtave në kompetenca komunale është të drejtat që pushteti qendror i delegon dhe që ushtrohen nga autoritetet lokale, por rregullimin e këtyre të drejtave e bënë ligji dhe mbikëqyrjen e bënë pushteti qendror, dhe

kompetenca e tretë është më specifike dhe që është ofertë e delegacionit të Kosovës, apo zoti Ahtisaari e ka vendosur si specifike, janë kompetencat e zgjeruara të disa komunave në fushën e arsimit dhe shëndetësisë. Kjo është krejt specifike dhe është përjashtim i asaj që në tjera vende njihet apo mund të quhet një lloj asimetrie e lehtë. Pika e dytë ka të bëjë me bashkëpunimin ndërkomunal, ndërkufitar dhe ndërinstitucional të komunave në fushën e këtyre kompetencave që ato ushtrojnë. Natyrisht, që ne kemi qenë të interesuar ta rregullojmë këtë fushë, por përveç të drejtave të komunave, rregullohet edhe e drejta e pushtetit qendror që të mbikëqyrë dhe që të detyroj zbatimin e ligjit në nivel lokal. Andaj autoriteti qendror është eksplicit, rregullon dhe formalizon mënyrën e bashkëpunimit dhe monitoron në të gjitha segmentet e kompetencave komunale. Por, autoriteti qendror nuk ndërhyn në të drejtat e komunave në ushtrimin e këtyre kompetencave, vetëm nëse ka tejkalim të autorizimeve, shkelje të ligjit apo në moszbatim të detyrës. Pika e tretë ka të bëjë me bashkëpunimin me institucionet e Serbisë dhe mënyrën e financimit që duhet ta bëjnë në këtë rrafsh. Natyrisht, që ne e njohim të drejtën e bashkëpunimit qoftë ajo në rrafshin e pushtetit lokal, qoftë ajo në rrafshin e bashkëpunimit në forma tjera. Serbia ka të drejtë të mbështes komunat me shumicë serbe me donacione financiare, por ato duhet të kalojnë nëpër Departamentin e The-sarit, nëpër banka të licencuara në Kosovë dhe të jenë të



mbikëqyrura nga autoritetet e Kosovës. Mjetet e dedikuara nuk mund t'ju ndryshohet destinimi, ato mjete duhet të shfrytëzohen për infrastrukturë, arsim, shëndetësi dhe çështje që i rregullojnë interesat e pushtetit lokal. Pjesa e fundit e kaptinës së decentralizimit ka qenë e fokusuar në themelimin e komunave të reja. Autoriteti ligjor i institucioneve qendror në raport me krejt komunat do të jetë i njëjtë. Nuk ka asnjë lloj dallimi, ashtu si do të mbikëqyret komuna e Gjilanit ashtu do të mbikëqyret edhe komuna e Graçanicës si dhe komunat tjera. Nëse ju pyetni se cili është dallimi me infrastrukturën e tashme ligjore dhe të ardhmen unë mund të ju them që tani Komunat nuk janë të kontrolluara në aspektin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në bashkëpunim me institucionet e Serbisë. Përkundrazi, ato kanë të drejtë që në mënyrë automatike për interesa të veta të lidhin çfarëdo lloj bashkëpunimi me gjithkënd që kanë interesa. Ndërsa, në të ardhmen kjo rregullohet dhe Ministria e Pushtetit Lokal është autoriteti final i cili e rregullon dhe legjitimon të gjitha format e bashkëpunimit.

*Nëse komunat serbe në veri reagojnë negativisht ndaj miratimit të rekomandimit për status të z. Ahtisaari në Këshillin e Sigurimit të KB, cili do të jetë reagimi i Qeverisë si dhe çfarë për-rahje pret Qeveria nga komunitetit ndërkombëtar?*

Lutfi Haziri: Më parë dua ta sqaroj një çështje për opinionin e Kosovës, tri komunat në veri të Kosovës që janë

Zubin Potoku, Leposaviçi dhe Zveqani janë institucione legjitime që kanë kaluar procesin zgjedhor në Kosovë. Ato janë themeluar dhe zgjedhur si institucione në përputhje me legjislacionin në Kosovë. Fatkeqësisht janë nën ndikim të qeveris së Serbisë dhe aplikojnë të ashtuquajturin standard të dyfishtë të implementimit të ligjit. Ky është problem që e përfshin një pjesë të komunës aktuale të Mitrovicës, pjesës verior të qytetit të Mitrovicës. Ndonëse rasti i Mitrovicës dallon pasi që administrohet nga përfaqësuesi i UNMIK-ut në komunën e Mitrovicës. Çdo tendencë që të pengohet implementimi i marrëveshjes për status apo e një rezolute të re të Këshillit të Sigurimit, besoj që do të ketë implikime në radhë të parë në fushën e sigurisë, që është mandati i forcave të NATO-s për garantimin e integritetit territorial, ruajtjen e sigurisë, pronës dhe të qytetarit të Kosovës. Nëse kemi të bëjmë me zbatimin e ligjit, Qeveria do të angazhohet seriozisht që në bashkëpunim me këto tri komuna të gjejë rrugë sa më të shpejt dhe sa më të shkurt që ta zbaton ligjin dhe nëse kemi problem me pengimin e zbatimit të marrëveshjes për status këtu është roli i prezencës së ardhshme ndërkombëtare në Kosovë. Përfaqësuesi ndërkombëtar në Kosovë, për të gjithë ata që do të dalin në kundërshtim me marrëveshjen, në kundërshtim me zbatimin e saj, do të ketë të drejta ekzekutive dhe do të duhet ta ushtron pushtetin e vet. Prandaj, unë do të kisha ndarë angazhimin tonë në tri rrafshë, rrafshi i

solucioneve të Kosovës – që nënkupton funksionalizimin dhe implementimin e ligjit të Kosovës, implementimi i marrëveshjes për status – që është roli i prezencës ndërkombëtare, dhe i sigurisë – që është mandati i NATO-së .

*Z. Haziri tani do të donim të trajtojmë fushën e marrëdhënieve të Qeverisë me Kuvendin e Kosovës, me fokus në procesin ligjvënës. Cila është bindja e juaj për gatishmërinë e Kuvendit që të miratohet 103 ligje në procedurën e rregullt, dhe rreth 17 ligje tjera që dalin prej obligimeve të propozimit të Ahtisaarit? Për më tepër kur dihet se ritmi i ekzistues i Kuvendit për miratimin e ligjeve është sillët rreth 20-25 ligje në vit. A ka caktuar Qeveria prioritetet në raport me miratimin e ligjeve, dhe cilat fusha konsiderohen prioritare?*

Lutfi Haziri: Ne e kemi aprovuar agjendën legjislative për këtë vit në të cilën Qeveria është sponsorues kryesor i ligjeve. Ne kemi plotësuar agjendën tonë legjislative me të gjitha ligjet dhe kërkesat për ndryshime të ligjeve që vije si pjesë e pakos së Ahtisaarit. Këtu përfshihen fushat si decentralizimi, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, zonave mbrojtëse, fushën e sigurisë dhe ato kërkesa eksplicite që z. Ahtisaari i përmend. Gjithashtu, ne do të bëjmë ndryshimin e dy ligjeve bazë në Kosovë, ligjit për arsim dhe shëndetësi sekondare. Unë jam i vetëdijshëm që do të ketë mbingarkesë Kuvendi i Kosovës me këtë agjendë legjislative, por prioriteti i yni është miratimi i të gjitha ligjeve që

dalin si pjesë e marrëveshjes për status dhe në vazhdimësi e nevojave që janë përcaktuar nga ana e qeverisë.

*A është Qeveria gati për përdorimin e tranzitore?*

Lutfi Haziri: Përmes mekanizmit të ri të grupeve teknike për tranzicion, dhe përgatitjen për gjendjes e pas statusit, besoj se do të arrijmë të vendosim oraret, dinamikën dhe potencialet tona në binarë të drejtë. Periudha 120-ditëshe e pas statusit, koha kur do të bëhet transferimi dhe absorrimi i të gjitha të drejtave dhe përgjegjësi që vijën nga administrata ndërkombëtare, do të jetë periudhë e sfidave të mëdha. Në të njëjtën kohë do të kemi instalimin e prezencës së ardhshme ndërkombëtare, e cila do të mbështesë Qeverinë dhe institucionet e Kosovës në fushat e drejtësisë dhe sigurisë. Kjo do të jetë një ndihmesë e madhe në kuptimin e kapaciteteve njerëzore dhe kapaciteteve tona legjislative.

*Së fundi, z. Haziri, ku e shihni Kosovën pas 10 vitesh?*

Lutfi Haziri: Absolutisht nuk kam asnjë lloj dyshimi që sfida ma e madhe pasi që Kosova të shpallet shtet i pavarur dhe sovran do të jenë integrimet evropiane. Do të jetë një sfidë e vështirë, do të jetë një sfidë e vështirë dhe e qartë me angazhime serioze që ky proces të kalojë. Unë e shoh Kosovën në familjen e madhe evropiane, si pjesë e familjeve sovraane në BE, si anëtare të barabartë e Komunitetit Evropian me angazhime krejt tjera dhe me agjendë zhvillimore.

## Shtetet e Bashkuara përkrahin rekomandimin e Ahtisarit për status

Pas një viti negociatash, i dërguari i posaçëm i Kombeve të Bashkuara dhe ish Presidenti i Finlandës, Marti Ahtisari, i dorëzoi Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara propozimet e tij për statusin e ardhshëm të Kosovës. Ne i falënderohemi Presidentit Ahtisari për punën e tij të durueshme, të shkathët dhe të baraspeshuar në udhëheqjen e procesit të statusit të Kosovës. Shtetet e Bashkuara i mirëpresin dhe përkrahin rekomandimet e tij.

Propozimet e të dërguarit të posaçëm të Kombeve të Bashkuara, për herë të parë

pas shumë vitesh, do t'i ofrojnë qartësi popullit të Kosovës rreth ardhmërisë së vet. Ato përmbajnë garanci të gjëra për të mbrojtur të drejtat dhe sigurinë e serbëve dhe komuniteteve tjera jo-shqiptare. Presidenti Ahtisari, gjithashtu, ka propozuar që Kosova të bëhet e pavarur dhe t'i nënshtrohet për një një periudhë të caktuar kohore të mbikëqyrjes ndërkombëtare.

Procesi i statusit të Kosovës është duke hyrë në fazën e tij të fundit dhe vendimtare. Në kohën kur Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara përgatitet të shqyrtojë rekoman-

dimet e Presidentit Ahtisari, ne do të angazhohemi në konsultime të plota dhe intensive me partnerët tonë në Këshillin e Sigurimit dhe me palët.

Zgjidhja e statusit të Kosovës duhet të shihet në kontekstin historik të rrethanave tragjike të shpërbërjes së Jugosllavisë, që filloj në vitet e 90-ta. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, i cili në vitin 1999 e miratoi rezolutën me të cilën vendosi Kosovën nën administrim të Kombeve të Bashkuara dhe parashikoi një proces politik për përcaktimin e statusit, prej kohe e ka trajtuar Kosovën si një rast të veçantë.

Qysh gjashtëmbëdhjetë vite më parë, kur filloi kriza në këtë rajon, Presidenti George W. Bush dhe dy pararendësit e tij kanë punuar në realizimin e një vizioni për një Evropë të njësuar, të lirë dhe në paqe. Ne besojnë që propozimet e Presidentit Ahtisari do të mundësojnë që rajoni t'i kapërcejë konfliktet e viteve 1990 dhe të lëviz drejt një të ardhme Euro-Atlantike më të ndritshme.

*Deklaratë nga Tom Casey,  
Zëvendës i Zëdhënësit të Departamentit të Shtetit, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më 26 mars 2007*



# S'ka Kushtetutë pa përfaqësim

Hajredin Kuçi, bashkë-kryesues i Grupit Përgatitor të Kushtetutës, Anëtar i Kuvendit të Kosovës, PDK



Në Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i dërguari special i Sekretarit të Përgjithshëm, Martti Ahtisaari ka theksuar që procesi kushtetues do të zhvillohet (Neni 10: Komisioni Kushtetues). Propozimi për statusin parashikon që Presidenti i Kosovës, në konsultim me Kryesinë e Kuvendit të Kosovës do të themelojë Komisionin Kushtetues për hartimin e Kushtetutës së Kosovës, në konsultim me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar. Propozimi më tutje parashihet që Komisioni Kushtetues të përbëhet prej njëzet e një anëtarëve. Tre anëtarë do të emërohen nga anëtarët e Kuvendit që mbajnë vendet e rezervuara për Komunitetin Serb, dhe tre anëtarë do të emërohen nga anëtarët e

Kuvendit që përfaqësojnë Komunitetet tjera. Pashyrjes në fuqi të propozimit të statusit, Kushtetuta do të miratohet brenda 120 ditësh nga shumica me dy të tretat e Kuvendit. Nga janari 2007, Grupi Përgatitor për Kushtetutën ka qenë duke themeluar kornizën kushtetuese për të lehtësuar punën e Komisionit Kushtetues.

Struktura e Kushtetutës së re do të duhej të harmonizohej me propozimin e statusit nga Ahtisaari. Gjuha relevante nga propozimi i statusit tanimë është përfshirë në kornizën kushtetuese të hartuar nga Grupi Përgatitor i Kushtetutës. Në këtë proces, kemi pasur mbështetjen e plotë të partnerëve ndërkombëtarë. Grupi Përgatitor për Kushtetutën shpreson që puna jonë fillestare do t'i mundësojë Komisionit Kushtetues të

shkruajë një Kushtetutë e cila do të plotësojë nevojat e Kosovës. Përveç kësaj, duhet ndërtuar edhe një mekanizëm për të siguruar që Kuvendi i Kosovës të ketë një rol gjatë gjithë procesit kushtetues.

Nuk ka donjë kalim të thjeshtë në kushtetutën e re. Mënyra e hartimit të kushtetutës është e rëndësishme po aq sa ajo që e thotë kushtetuta. Procesi i hartimit të kushtetutës i jep legjitimitetin kushtetutës. Proceset moderne kushtetuese po rridefinojnë traditën e kaluar të hartimit të kushtetutës nga "ekspertët" si dhe po përafron procesin në sferën e pjesëmarrjes demokratike. Normat e procedurës demokratike, transparenca dhe përgjegjshmëria të cilat aplikohen në vendim-marrjen e përditshme politike, janë të nevojshme edhe në përpjekjet kushtetuese.

Marrëveshja e Presidentit Ahtisaari për statusin ofron mundësi të zhvillimit të një procesi kushtetues që janë më transparente dhe përfshirëse. Parimet e Përgjithshme 10.3 nga propozimi i statusit thërret për një "mekanizëm kuptimplotë për të informuar anëtarët e publikut" mbi punën e Komisionit Kushtetues. Ka nevojë për një pajtim më të gjerë politik mbi procesin e përgjithshëm kushtetues para periudhës tranzitore, për të shmangur konfliktin në fazat më kritike të procesit.

Hartimi pjesëmarrës kushtetues sot është pjesë e domosdoshme e procesit kushtetues. Përkundër

vështirësive sfiduese të definimit dhe zbatimit, procesi demokratik i hartimit të kushtetutës është kritik për fuqinë, pranueshmërinë dhe ligjshmërinë e prodhimit përfundimtar. Pjesëmarrja publike shpesh kuptohet të jetë votimi, zgjedhja e elektoratit apo ratifikimi i një teksti kushtetues me anë të referendumit. Megjithatë, formë tjetër e pjesëmarrjes është iniciativa e vetë qytetarëve, për të krijuar një dialog të hapur kushtetues, ku opinioni ndan edhe caktimin e agjendave, përmbajtjes dhe ratifikimit. Nuk duhet harruar që pjesëmarrja e vërtetë publike kërkon përfshirje sociale, siguri personale dhe liri të fjalës dhe liria për asociim. Shoqëria e fuqishme civile, edukimi qytetar, si dhe kanalet e mira të komunikimit mes gjithë niveleve të shoqërisë e lehtësojnë këtë proces. Vetëm një përkushtim i konsiderueshëm i kohës dhe resurseve mund ta mundësojë pjesëmarrjen e vërtetë publike në Kosovë.

Hartimi pjesëmarrës i kushtetutës është bërë aspekt thelbësor i procesit legjitim kushtetues. Aty ku procesi kushtetues ndahet me opinionin, bërja e kushtetutës nuk është më e kufizuar në kuadër të "politikës së lartë" dhe negociatave mes pjesëtarëve të elitës që hartojnë tekstet pas dyerve të mbyllura. Në fund, kjo çon në një kushtetutë përfaqësuese dhe legjitime – i vetmja e pranueshme për qytetarët e Kosovës.



# Përmbledhje e përgjithshme e propozimit gjithëpërfshirës

## I. Të Përgjithshme

Synimi i Propozimit të Gjithanshëm për Marrëveshjen mbi Statusin e Kosovës është të përcaktojë kërkesat e nevojshme për një Kosovë të ardhshme që është e mundshme, e mbështetshme dhe e stabilizuar. Ai përfshin masa të hollësishme për të siguruar inkurajimin dhe mbrojtjen e të drejtave të bashkësive të anëtarëve të tyre, decentralizimin efektiv të qeverisë dhe ruajtjen e mbrojtjen e trashëgimisë kulturore e fetare. Për më tepër, Marrëveshja përshkruan masa kushtetuese, ekonomike dhe sigurie, të cilat së bashku synojnë të kontribuojnë në zhvillimin a një Kosove shumë-etnike, demokratike dhe të lulëzuar. Një element i rëndësishëm i Marrëveshjes është mandati që i jepet një prezence ndërkombëtare civile dhe ushtarake në Kosovë për të mbikëqyrur zbatimin e Marrëveshjes dhe për të ndihmuar autoritetet kompetente Kosovare në sigurimin e paqes dhe stabilitetit në gjithë Kosovën. Dispozitat e Marrëveshjes do të kenë përparësi mbi të gjitha dispozitat e tjera ligjore në Kosovë.

## II. Elementët e Marrëveshjes

Marrëveshja përfshin pjesën kryesore me katërmbëdhjetë nene që përbëjnë parimet e saj kyçe, dhe dymbëdhjetë Shtojca, të cilat zgjerojnë më tej këto parime:

Kosova do të jetë një shoqëri shumë-etnike, që e qeveris veten në mënyrë demokratike dhe me respekt të plotë për rendin ligjor, nivelin më të lartë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të pranuar nga bota ndërkombëtare, dhe që nxit ekzistencën paqësore dhe të lulëzuar të gjithë banorëve të saj.

Kosova do të miratojë një Kushtetutë për të mbrojtur këto parime. Ndërsa Marrëveshja nuk përshkruan një Kushtetutë të plotë, ajo përkufizon elementët kyç që duhet të bëjnë pjesë në Kushtetutë.

Kosova do të ketë të drejtë të diskutojë dhe të miratojë marrëveshje ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën për të kërkuar anëtarësi në organizata ndërkombëtare.

Mbrojtja dhe përkrahja e të drejtave të anëtarëve të bashkësive është një element qendror i Marrëveshjes. Marrëveshja përcakton aspektet kyçe që do të mbrohen, duke përfshirë kulturën, gjuhën, edukimin dhe simbolet. Ajo gjithashtu përshkruan mekanizma specifike të përfaqësimit të anëtarëve të bashkësive jo-Shqiptare të Kosovës në institucionet publike kryesore për të ruajtur dhe përkrahur pjesëmarrjen e tyre efektive dhe aktive në jetën publike. Për të mbrojtur të drejtat e bashkësive Kosovare jo-Shqiptare në procesin legjislativ, Marrëveshja gjithashtu lejon që disa ligje të caktuara mund të hyjnë në fuqi vetëm nëse një shumicë e anëtarëve Kosovare jo-Shqiptare të Asamblesë Kosovare janë dakord me miratimin e tyre.

Marrëveshja përmban një propozim me përmasa të gjëra për decentralizim, i cili është i një shkalle të zgjeruar dhe synon të përkrahë qeverisjen e mirë, transparencën dhe efikasitetin në shërbimin publik. Propozimi përqendrohet në veçanti në nevojat e shqetësimit specifike të bashkësisë Kosovare Serbe, e cila do të ketë një shkallë të lartë kontrolli mbi punët e veta. Elementet e decentralizimit përfshijnë, inter-alia, kompetenca të reja bashkiake për bashkësitë me shumicë Kosovare Serbe (si për shembull në fushat e shëndetësisë së shkallës së

dytë dhe të arsimit të lartë); autonomi të zgjeruar bashkiake në çështjet financiare, duke përfshirë aftësinë për të pranuar fonde transparente nga Serbia për një diapazon të gjerë aktiviteteve e qëllimesh bashkiake; masa mbi aleanca mes bashkive dhe bashkëpunimin përmes kufijve me institucione Serbe; dhe krijimin e gjashtë bashkësive të reja ose mjaft të zgjeruara me shumicë Serbe (Graçanica, Novo Bërdo, Kllokoti, Ranillugi, Parteshi, Mitovica-Veriore).

Marrëveshja gjithashtu përcakton një sistem drejtësie në Kosovë i cili është i integruar, i pavarur, profesional dhe i pa-anshëm, që i siguron drejtësi të gjithë personave në Kosovë. Ajo gjithashtu përcakton mekanizma për të siguruar që sistemi i drejtësisë është përfshirës dhe që shërbimi i tij gjyqësor dhe prokuror pasqyron karakterin shumë-etnik të Kosovës.

Elementet e Marrëveshjes për mbrojtjen dhe nxitjen e trashëgimisë fetare e kulturore do të sigurojnë ekzistencën a papenguar e të patruar të Kishës Ortodokse Serbe (KOS) në Kosovë. Më shumë se dyzet vende kyçe fetare e kulturore do të rrethohen nga Zona Mbrojtëse për të parandaluar zhvillime apo ndërtime të dëmshme tregtare dhe industriale, dhe për të ruajtur dinjitetin kulturor të këtyre vendeve. Marrëveshja gjithashtu garanton sigurinë fizike të përforcuar për vende të zgjedhura. KOS the organizata e saj e brendshme do të njihen haptazi nga autoritetet Kosovare dhe do t'i njihet e drejta a paprekshmërisë së pronës, liria nga taksimi dhe privilegje doganore. KOS në Kosovë gjithashtu do të jetë e lirë të mbajë lidhje me KOS në Beograd.

Të gjithë refugjatët dhe personat e shpërngulur brenda Kosovës do të kenë të drejtë të kthehen dhe të marrin sërish pasuritë dhe pronat e tyre personale. Marrëveshja gjithashtu u bën thirrje Kosovës dhe Serbisë të bashkëpunojnë plotësisht me Komisionin Ndërkombëtar të



# përfundimtar për zgjidhjen e statusit të Kosovës

Kryqit të Kuq për të zgjidhur fatin e personave të zhdukur.

Marrëveshja përfshin masa të veçanta që synojnë të nxisin e të ruajnë zhvillimin e vazhdueshëm ekonomik në Kosovë. Ajo përshkruan procedura transparente për të zgjidhur mosmarrëveshje lidhur me pronat dhe për një proces privatizimi të vazhdueshëm, të dyja këto me një pjesëmarrje të konsiderueshme ndërkombëtare. Për më tepër, Marrëveshja përkufizon mekanizma për të përcaktuar pjesën e Kosovës në borxhin e huaj të Serbisë dhe për të zgjidhur çështjen e kthimit të pronave.

Marrëveshja gjithashtu parashikon një sektor sigurimi në Kosovë i cili është profesional, shumë-etnik, dhe demokratik, dhe inkurajon një përfshirje të rëndësishme lokale në zhvillimin e tij dhe në të njëjtën kohë ruan nivelin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të nevojshëm për suksesin përfundimtar në këtë fushë delikate. Forca Policore Kosovare do të ketë një varg komande të njësuar në mbarë Kosovën, ndërkohë që oficerët lokalë të policisë do të pasqyrojnë përbërjen etnike të bashkësisë në të cilën ata shërbejnë. Në bashkitë Kosovare me shumicë Serbe, Asambleja Bashkiake do të ketë kompetenca të avancuara në zgjedhjen e Komandantit të Stacionit lokal. Një Forcë Kosovare Sigurimi (FKS) e re dhe shume-etnike to të krijohet brenda një viti. Do të ketë një maksimum prej 2,500 anëtarësh aktivë dhe 800 rezervistë. Marrëveshja kërkon që Korpusi i Mbrojtjes së Kosovës (KMK) që ekziston sot do të shpërndahet brenda një viti.

Duke pranuar faktin që përmbushja e përgjegjësi të Kosovës sipas Marrëveshjes kërkon një diapazon të gjerë aktiviteteve komplekse dhe të vështira, Marrëveshja përcakton një prani ndërkombëtare në të ardhmen për të mbikëqyrur dhe përkrahur përpjekjet e duhura të

autoriteteve Kosovare. Kjo prani përfshin tre komponentë kryesorë:

Një Përfaqësues Ndërkombëtar Civil (PNC), gjithashtu i njohur si Përfaqësuesi i Posaçëm i BE, do të emërohet nga një Grup Drejtues Ndërkombëtar (GDN), i cili përfshin aktorët kryesorë ndërkombëtare. PNC do të ketë autoritetin më të lartë mbikëqyrës mbi zbatimin e Marrëveshjes. PNC do të vishet me kompetenca të veçanta që do ta lejojnë atë të marrë veprimet e duhura për të mbikëqyrur dhe siguruar zbatimin e suksesshëm të Marrëveshjes. Këto kompetenca përfshijnë autoritetin për të anuluar vendime apo ligje të miratuara nga autoritetet Kosovare dhe për të ndëshkuar apo hequr nga pozita ata zyrtarë veprimet e të cilëve PNC gjykon që nuk pajtohen me frymën e Marrëveshjes. PNC gjithashtu do të jetë autoriteti vendimtar në Kosovë për sa i përket aspekteve civile të Marrëveshjes.

Një Mision i Politikës Evropiane për Sigurinë e Mbrojtjen (PESM) do të vrottojë, mësojë dhe këshillojë në të gjitha fushat e lidhura me shtetin ligjor. Veçanërisht, ai do të ndihmojë Kosovën në zhvillimin e institucioneve policore, gjyqësore, e institucionet penale efikase, të paanshme dhe përfshirëse, dhe do të ketë autoritetin për të marrë përsipër përgjegjësi të tjera për të siguruar ruajtjen dhe përkrahjen e shtetit ligjor, rendit publik dhe sigurisë.

Një Prani Ushtarake Ndërkombëtare e udhëhequr nga NATO do të krijojë një mjedis të mbrojtur dhe të sigurt në gjithë Kosovën, në bashkëpunim me PNC dhe në mbështetje të institucioneve të Kosovës deri sa të vijë koha kur këto institucione të jenë në gjendje të marrin përsipër të gjithë diapazonin e përgjegjësi të sigurisë.

OSBE, me një prani të gjerë në terren në Kosovë, do të kërkohet të ndihmojë në mbikëqyrjen e nevojshme për zbatimin e suksesshëm të Marrëveshjes.

## III. Zbatimi i Marrëveshjes

Sapo Marrëveshja të hyjë në fuqi, do të ketë një periudhë tranzicioni prej 120 ditësh, gjatë së cilës mandati ekzistues i UNMIK-ut do të mbesë i pandryshuar. Megjithatë, për të siguruar mbikëqyrjen e menjëhershme të zbatimit të Marrëveshjes nga Kosova, PNC do të ketë autoritet për të monitoruar këtë zbatim dhe për të bërë rekomandime tek UNMIK për veprime që duhen marrë për të siguruar respektimin e Marrëveshjes.

Gjatë periudhës së tranzicionit, Asambleja Kosovare, në konsultime me PNC, do të ketë përgjegjësinë të aprovojë një Kushtetutë dhe legjislacionin e nevojshëm për zbatimin e Marrëveshjes. Kushtetuta dhe legjislacioni i ri do të hyjnë në fuqi menjëherë pas përfundimit të periudhës së tranzicionit.

Në përfundimin e periudhës së tranzicionit, mandati i UNMIK-ut do të mbarojë dhe i gjithë autoriteti legjislativ dhe ekzekutiv që UNMIK-u gëzon do t'i kalohet në tërësi autoriteteve të Kosovës, në përputhje me Marrëveshjen.

Brenda nëntë muajve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, zgjedhje të përgjithshme dhe lokale duhet të mbahen.

Mandati i PNC do të vazhdojë deri sa GDN të vendosë që Kosova ka zbatuar kushtet e Marrëveshjes.



# Hapat drejt definimit statusit të Kosovës

I Dërguari i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për procesin e statusit të ardhshëm për Kosovë (DP) Martti Ahtisaari dhe Zëvendësi i të dërguarit të posaçëm (ZDP) Albert Rohan, në nëntor të vitit 2005 për herë të parë i kishin vizituar palët dhe rajonin, duke vizituar Prishtinën dhe Beogradin, si dhe kryeqytetet e shteteve fqinje Tiranën, Podgoricën dhe Shkupin. Që nga ajo kohë, i Dërguari i Posaçëm, zëvendësi i tij dhe anëtarët e zyrtarëve të lartë të Zyrës së Kombeve të Bashkuara të Dërguarit të Posaçëm për Kosovën (ZKBDPK/UNOSEK) kanë bërë vizita të shpeshta në rajon.

Në vazhdimë të vitit 2006, ZKBDPK kishte mbajtur 15 runde të bisedimeve të drejtpërdrejta ndërmjet ekipeve negociatore të Beogradit dhe të Prishtinës.

Katërmbëdhjetë nga këto runde të bisedimeve ishin përqendruar në decentralizim, për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare në Kosovë, për çështjet ekonomike dhe për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve.

Krahas kësaj, më 24 korrik të vitit 2006, në Vjenë, i Dërguari i Posaçëm kishte udhëhequr bisedimet e drejtpërdrejta të udhëheqësve serbë dhe të Kosovës DP. Kryetari Boris Tadiq dhe Kryeministri Vojislav Koshtunica e kishin udhëhequr delegacionin e Serbisë, përderisa Kryetari Fatmir Sejdiu e kishte udhëhequr Ekipin e Unitetit të Kosovës. Takimi iu kishte të dy palëve mundësinë që në nivelin më të lartë, njëra tjetrës t'ia paraqes pikëpamjet e veta për të ardhmen e Kosovës, po ashtu edhe komunitetit ndërkombëtar, të përfaqësuar si nga ZKBDPK, ashtu edhe vëzhguesit e Grupit

të Kontaktit (GK), Unionit Evropian dhe të NATO-s.

Krahas këtyre bisedimeve të drejtpërdrejta ndërmjet palëve, që nga janari i vitit 2006, 26 misione të ekspertëve të ZKBDPK kishin vizituar Beogradin dhe Prishtinën për të biseduar ndaras me palët për çështjet e ndryshme.

Siç duket, që nga nëntori i vitit 2005, i Dërguari i Posaçëm (DP) dhe zëvendësi i tij kishin bërë takime të zgjuara me akterët tjerë në proces. Ato kishin përfshirë takimet në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (4 mars, 13 korrik dhe 22 shtator të vitit 2006); takimet me GK, me Ministrat e Punëve të Jashtme të BE-së, si dhe me akterët tjerë ndërkombëtarë, përfshirë këtu NATO-n dhe OSBE-në.

Më 25 janar të vitit 2007, i Dërguari i Posaçëm takoi Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Ban Ki-Moon në Paris për ta njoftuar atë për zhvillimet më të reja në procesin e statusit dhe kishte këmblyer propozim të ndërsjellë

me të. Në ditën e nesërme, i Dërguari i Posaçëm ishte takuar në Vjenë me anëtarët e Grupit të Kontaktit (GK) dhe gjithashtu kishin këmblyer përmbajtjet e propozimit të tij, si pjesë e konsultimeve të rregullta dhe të procesit të bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet ZKBDPK-së dhe Grupit të Kontaktit (GK).

Më 2 shkurt, i Dërguari i Posaçëm kishte udhëtuar në Beograd dhe në Prishtinë për t'iu prezantuar të dy palëve pakon gjithëpërfshirëse për zgjedhjen e statusit të Kosovës. Në Beograd, pakoja iu ishte dorëzuar Kryetarit të Serbisë Boris Tadiq. Në Prishtinë, i Dërguari i Posaçëm ia kishte prezantuar pakon e tij Kryetarit Fatmir Sejdiu dhe Ekipit të Unitetit.

I Dërguari i Posaçëm më pas i kishte ftuar të dy palët që të takohen disa herë në Vjenë për diskutuar për pakon. Gjatë rundit të parë të bisedimeve, të mbajtur ndërmjet 21 shkurtit dhe 2 marsit, delegacionet e kishin rishqyrtuar tërë dokumentin. ZKBDPK më pas e kishte

rishikuar hartimin fillestar të planit të saj, dhe më 10 mars, i Dërguari i Posaçëm i kishte ftuar përfaqësuesit më të lartë të dyja palëve që të marrin pjesë në takimim e nivelit të lartë në Vjenë. Delegacioni i Beogradit ishte i udhëhequr nga Kryetari Boris Tadiq dhe Kryeministri Vojislav Koshtunica, dhe Ekipi i Unitetit i Prishtinës ishte udhëhequr nga Kryetari Fatmir Sejdiu. Gjithashtu në këtë takim kishin marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Grupit të Kontaktit, Unionit Evropian dhe të NATO-s.

Në fund të takimit të nivelit të lartë, i Dërguari i Posaçëm kishte vërejtur se nuk kishte pasur vullnet nga palët për të ecur përpara nga qëndrimet e tyre të mëparshme. I Dërguari i Posaçëm kishte konkluduar se potenciali i negociatave ishte shterur dhe nuk kishte pasur ndonjë dyshim se qëndrimet përkatëse të palëve për statusin e Kosovës nuk kanë përmbajtur ndonjë bazë për të arritur ndonjë marrëveshje, dhe se asnjë masë e negociatave shtesë nuk do të ndryshonte faktin. Ai ishte deklaruar për qëllimin e tij për ta finalizuar pakon e tij për ta paraqitur atë para Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara gjatë muajit mars.

Më 14 mars, Zëvendësi i të Dërguarit të Posaçëm Albert Rohan shkoi në Nju Jork për t'ia dorëzuar Sekretarit të Përgjithshëm pakon finale për zgjedhjen e statusit për Kosovën, si dhe raportin e të Dërguarit të Posaçëm të Sekretarit të përgjithshëm për statusin e Kosovës. Raporti dhe pakoja zyrtarisht janë dorëzuar te anëtarë i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 mars.

## Lista e bisedimeve të drejtpërdrejta ndërmjet delegacioneve të Beogradit dhe Prishtinës

- Takimi i udhëheqësve serbë dhe të Kosovës në Vjenë (24 korrik 2006)
- Tetë takime në lidhje me decentralizimin: (20-21 shkurt 2006, 17 mars 2006, 3 prill 2006, 5 maj 2006, 19 korrik 2006, 7 gusht 2006, 7 shtator 2006 dhe 15 shtator 2006)
- Tri takime në lidhje me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare në Kosovë (23 maj 2006, 18 korrik 2006 dhe 8 shtator 2006)
- Dy takime në lidhje me të drejtat e komunitetit: (8 gusht 2006 dhe 8 shtator 2006)
- Një takim në lidhje me çështjet ekonomike: (31 maj 2006)



# Misioni i ri i BE-së do të mbështesë aspiratat e Kosovës për anëtarësim në BE dhe NATO

Intervistë me z. Ardian Gjini, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe anëtar i Grupit Politik Strategjik të Ekipit Negociator të Kosovës

*A do të jetë Kosova vërtetë e pavarur nëse vazhdon të ketë një administrim kaq të fuqishëm ndërkombëtar?*

Ardian Gjini: Me siguri që do të jetë e pavarur. Ekzistojnë mënyra për të kuptuar pavarësinë. Elementi i parë të cilin dua të përmendë është që pavarësia dhe sovraniteti janë të përvokueshëm. Elementi i dytë është se ajo (pavarësia) do të njihet nga pjesa tjetër e botës dhe besoj se kjo njohje, mbi të gjitha, do të jetë elementi më i rëndësishëm i sovranitetit për një vend të vogël siç është Kosova. Dhe elementi i tretë është që misioni i ri në Kosovë nuk do të vendosë për të ardhmen tonë, që nënkupton që elementi i fundit është që sovraniteti ka të bëjë me faktin që ne do të vendosim për të gjitha çështjet që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetërat tona, dhe jo dikush tjetër. Kjo do të thotë që Kosova do të jetë e pavarur, pavarësisht nga fakti që do të ketë një mision pas statusit, i cili do të monitorojë zbatimin e propozimit gjithëpërfshirës. Por, ne gjithashtu shpresojmë se ky mision i ri në esencë do të monitorojë përpjekjet tona serioze për të realizuar objektivat tona.

*Nga ajo çfarë thatë ju, Kosova, sipas shumicës së vëzhguesve ndërkombëtar ka përparuar mjaft që nga viti 1999, me siguri më shumë se Bosnja. Megjithatë, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN) do të jetë ngjashëm si Zyra e Përfaqësuesit të Lartë në Bosnjë. PCN-ja do të ketë autorizimin e përgjithshëm për të anuluar ligje ose vendime të marra nga autoritetet e Kosovës,*



*të largojë zyrtarët publikë etj. Pse PCN-së iu janë dhënë autorizime kaq të mëdha dhe si mund të arsyetohet kjo para popullit të Kosovës?*

Ardian Gjini: Do të përmendja dy arsye që për momentin më vijnë ndërmend. Arsyeya e parë është e thjeshtë; nëse dikujt i jepet autorizimi për të monitoruar marrëveshjen për statusin, ky autorizim do të duhet të ketë një pushtet të caktuar për të ndikuar në zbatimin e pakos, që po ashtu do të thotë miratimin e ligjeve, procedurave dhe vendimeve të caktuara të cilat do të duhej të jenë në përputhje të plotë me pakon. Ndërsa arsyeja e dytë, që në masë të madhe është e lidhur me të parën, është se në këtë fazë kur ne po presim Rezolutën e re të Këshillit të Sigurimit dhe gjithashtu kur po kalojmë nëpër

procesin e negociatave në Vjenë, edhe anëtarët e Grupit të Kontaktit kanë kaluar dhe po kalojnë nëpër një lloj procesi të negociatave gjithashtu. Garancione u janë nevojitur të gjithëve apo së paku që Kosova do t'i përmbahet marrëveshjes. Prandaj, këto janë arsyeet pse do të kemi këtë mision të ri, dhe siç e thashë më sipër, ne do të dëshironim të shohim këtë mision si mision mbështetës për aspiratat e Kosovës drejt anëtarësimin në BE dhe NATO.

*Sa i përket reformës së gjyqësorit, si mendoni që PCN-ja mund të ndihmojë në këtë reformë, nëse do të ketë një spektër të gjerë të autorizimeve siç është emërimi i hetuesve dhe prokurorëve ndërkombëtarë të cilët mund të veprojnë në mënyrë të pavarur?*

Ardian Gjini: Mendoj që gjëja më

e rëndësishme është që ata do të punojnë në kuadër të kornizës ligjore dhe kushtetuese të Kosovës. Dhe sërish, nëse e marrim parasysh këtë fakt, atëherë mund të kuptojmë këtë mision si mbështetje për gjyqësorin e Kosovës. Ne nuk jemi në kundërshtim me procedurat dhe ligjet e BE-së; vetëm dëshirojmë të jemi sa më kompatibil. Pra, nëse i kemi parasysh këto dy gjëra, se na nevojitet mbështetja dhe dëshirojmë që të jemi kompatibil, në një fazë, pa marrë parasysh se kur, për të qenë në gjendje që t'i bashkohemi BE-së, kjo nuk do të jetë pengesë dhe në për më tepër do të jetë një mbështetje për ne.

*Si i parashihni marrëdhëniet ndërmjet PCN-së dhe Qeverisë së Kosovës, për shembull përkittazi me llogaridhënien dhe raportimin ndaj Qeverisë?*

Ardian Gjini: Ekipi Planifikues i BE-së deri më tani ka bërë një punë shumë të mirë jo vetëm në përgatitjen e misionit dhe dhënien e informatave për institucionet e BE-së dhe për bashkësinë ndërkombëtare për atë se çfarë forme do të ketë ky mision, por edhe në përgatitjen e terrenit për konsultime me ne. Kjo do të thotë se ky partneritet i ardhshëm ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe misionit të ri ndërkombëtar, kryesisht me misionin BE-së, do të ketë një bazë për një partneritet të vazhdueshëm. Mendoj që ky partneritet tashmë ka filluar si një histori e mirë dhe mendoj se kjo, mes tjerash, do të jetë në interes të përbashkët. Andaj, unë nuk shoh ndonjë problem real në forcimin e këtij partner-

iteti për aq kohë sa ky mision të jetë në Kosovë.

*Mandati i organizatave ndërkombëtare siç janë OSBE-ja, Këshilli i Evropës, UNDP-ja, FMN-ja, Banka Botërore etj. do të ndryshojë pas statusit. A do të ndryshojë qëndrimi i Qeverisë së Kosovës në raport me to?*

Ardian Gjini: Besoj se shumica e njerëzve e dinë që ka qenë një përpjekje e përhershme për të kërkuar pavarësinë dhe sovranitetin, që do të thotë se ne gjithnjë kemi kërkuar për t'u anëtarësuar në të gjitha institucionet që u përmendën më lartë. Dhe përsëri, prania e tyre nënkupton një mbështetje të caktuar dhe nuk kemi dyshim se kështu edhe do të jetë. Por natyrisht se do të jetë ndryshe, pasi që do të veprojnë në një vend të pavarur dhe sovran, pavarësisht nga fakti se ajo do të jetë e mbikëqyrrur.

*Duke marrë parasysh autorizimet e PNC-së, a besoni se do të jetë e lehtë që t'i zvogëlohen kompetencat dhe shpeshësia e intervenimeve?*

Ardian Gjini: Do të thoja që kjo sigurisht do të varet nga puna që ne bëjmë në Kosovë dhe nga ajo se në çfarë mase do të zhvillojmë konsultime paraprake. Veç kësaj, do të varet se a do të paraqitet nevoja për të ndërmarrë ndonjë masë. Nuk mendoj se do të ketë shumë intervenime, nuk dua të them se nuk do të ketë asnjë, por mendoj se nuk do të ketë shumë, pasi që tani perceptimi në Kosovë është se ne duhet dhe dëshirojmë që ta zbatojmë pakon. Pra, ka vullnet, ka shumë entuziazëm andaj në bazë të kësaj, nuk mendoj që PNC-ja i ri do të ketë edhe aq shumë punë për të bërë.

*Ju faleminderit shumë z. Ministër.*

## “Plani i Ahtisaarit do të sigurojë përparim dhe kuptim të ri për bashkë-jetesën në Kosovë”

Intervistë me Branislav Grbic, Ministër për Kthim dhe Komunitete



*Ministër, a jeni të kënaqur me procesin e kthimit?*

Branislav Grbic: Si Ministër për Kthim dhe Komunitete, si dhe qytetar i Kosovës, më duhet të them që nuk jam i kënaqur. Fatkeqësisht, numri i të kthyerve është ende tejet i vogël, dhe shumë njerëz ende jetojnë larg nga shtëpitë e tyre. Besoj që ky proces mund dhe duhet të jetë më i shpejtë. Është fakt që prej hyrjes në fuqi të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të KB 1244 më 1999, disa kushte politike dhe të sigurisë të cilat mundësojnë kthimin janë krijuar, për ta bërë procesin e kthimit më të suksesshëm. Gjatë këtyre viteve, numri i të kthyerve ka ndryshuar në ndërthurje me ndryshimet e

gjendjes në terren. Në këtë kuptim, kemi nevojë për përpjekje dhe përkrahje të fuqishme nga përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare dhe Qeverisë Serbe, për të siguruar që individët ta kenë të garantuar të drejtën e tyre për t'u kthyer në shtëpitë e tyre.

*Cilat janë pengesat kryesore ndaj kthimit të të zhvendosurve sot?*

Branislav Grbic: Fillimisht, pengesat kanë të bëjë me gjendjen politike dhe të sigurisë. Mund të themi që gjendja është më e mirë sesa ishte, dhe që sot ka mundësi më të mëdha për kthim. Qëndrueshmëria ekonomike është elementi i dytë i rëndësishëm i procesit të kthimit; në

thelb kjo do të shtron pyetjen se çfarë duhet të bëhet pas kthimit? Kjo është çështje serioze dhe komplekse, e cila kërkon angazhimin e të gjitha palëve të përfshira, pasi jeta në Kosovë mbizotërohet nga një ekonomi e dobët, me nivel të lartë të papunësisë.

*Cili është projekti më i suksesshëm i kthimit që është ndërmarrë nga Ministria?*

Branislav Grbic: Qysh prej themelimit të Ministrisë, gjitha projektet janë ndërmarrë në bashkëpunim me përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare, gjegjësisht UNDP dhe OJQ-të si paraqitës të dokument-koncepteve. Projekti i Zoqishtes është i vetmi projekt që Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit e ka ndërmarrë si e pavarur. Shpresojmë që ai do të përmbyllet në maj, kur do t'i dorëzojmë 38 palë çelësa tek të kthyerit. Një nga projektet më të rëndësishme të MKK-së dhe UNDP-së është projekti i kthimit në Klinavac, Komuna e Klina/Klinës. Një projekt tjetër që është zbatuar në bashkëpunim me UNDP-në dhe Perspektivën Evropiane është kthimi i 74 familjeve në Babushë/Srpski Babush, projekt i shumë i mirë që është duke u implementuar me sukses.

*Cilat janë planet e Ministrisë për vitin 2007?*

Branislav Grbic: Ministria ka rifilluar bashkëpunimin me përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare përmes takimeve më të shpeshta, cilësore dhe të suksesshme. Në pajtim

me buxhetin prej 5,200,000 eurosh në dispozicion të Ministrisë, ne jemi pajtuar të përkushtojmë 2,100,000 Euro për projektin SPARK, të implementuar nga UNDP-ja. Fonde do të jepen edhe për të ndihmuar kthimin e familjeve serbe në Dobri Dub, Fushë Kosovë/Kosovo Polje dhe fshatin Nakarade, Komuna e Klinës/Klina. Secilit projekt do t'i ndahen nga 850,000 euro. Gjithashtu, kemi dhënë 500,000 euro për projektet individuale që do të ndërmerren nga UNDP-ja këtë vit. Jam i kënaqur të them që më 2007, për herë të parë, ne në mënyrë të pavarur do t'i implementojmë dy projekte kthimi: një në qytetin e Prizrenit, i cili përfshin rindërtimin e 15 shtëpive serbe, si dhe kthimin e 20 familjeve rome në Vushtrri/Vučitrn, për të cilin kemi ndarë 504,000€. Ministria gjithashtu ka ndarë 2 milionë € për projektet e përkrahjes në komunitet, si dhe ka informuar secilën komunë në Kosovë sa i përket kritereve të nevojshme që projektet të financohen nga Ministria, në mënyrë të arritjes së qëndrueshmërisë së komuniteteve.

*Si do ta vlerësonit ju propozimin e Ahtisaarit, i cili aktualisht po diskutohet nga Këshilli i Sigurimit?*

A: Plani i Ahtisaarit është vazhdimësi e politikës së bashkësisë ndërkombëtare për zgjidhjen e çështjes së statusit të Kosovës. Kuvendi i Kosovës e ka deklaruar këtë plan si të pranueshëm. Shpresoj që versioni përfundimtar i planit do të sigurojë përparim dhe kuptim të ri për bashkë-jetesën në Kosovë.

*A mendoni që procesi negociator ka përfshirë gjithë interesat e komuniteteve pakicë në Kosovë?*

Branislav Grbic: Nuk ekziston propozim ideal. Unë kam mendimin që një propozim apo zgjidhje e tillë, në kuptimin e bashkë-jetesës, do të ketë ndikim pozitiv në qëndrueshmërinë ekonomike dhe fizike të gjithë qytetarëve në Kosovë.

*Sa i përket kthimit, si mund të përfitojnë komunitetet pakicë nga ky propozim?*

Branislav Grbic: Para se gjithash, propozimi duhet të plotësojë nevojat e sigurisë së pakicave, ashtu që askush të mos ndjehet i injoruar apo i lënë anash. Pa marrë parasysh shtetësinë, etninë, fenë apo nëse personi është anëtar i komunitetit shumicë apo pakicë, secili në Kosovë duhet të ndjehet i sigurtë. Komuniteti shumicë në Kosovë duhet të ofrojë siguri. Qeveria e Kosovës, Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes dhe bashkësia ndërkombëtare duhet të garantojnë sigurinë për të gjithë, ashtu që njerëzit të ndjehen të sigurtë dhe të kenë jetë normale e të civilizuar si çdo qytetar tjetër evropian.

*Cili do jetë roli i Ministrisë në procesin e zbatimit të zgjidhjes së statusit, si dhe a keni resurset e nevojshme për të luajtur atë rol?*

Branislav Grbic: Ne kemi propozuar buxhetin për vitin 2007, i cili është miratuar pa marrë parasysh zbatimin e procesit të statusit. Mendoj që kjo Ministri do të harmonizojë punën e saj me politikën e bashkësisë ndërkombëtare dhe institucioneve të përkohshme, si dhe të krijojë kushtet e nevojshme për kthimin e qëndrueshëm dhe cilësor.

*A keni ndonjë porosi për të zhvendosurit që planifikojnë të kthehen në shtëpitë e tyre?*

Branislav Grbic: Porosia ime

kryesore është që çdokush që ka jetuar këtu dhe dëshiron të kthehet, ta bëjë këtë. Jam i vetëdijshëm që themelet kryesore të kthimit janë kushtet financiare dhe siguria. Pasi përpjekjet për zgjidhjen e përhershme të situatës politike dhe të sigurisë tanimë ekzistojnë, si dhe nëse elementi ekonomik i nevojshëm për të shpejtuar procesin e kthimit sigurohet përmes buxhetit të Institucioneve të Përkohshme dhe donacionet, qytetarët duhet të insistojnë dhe të kenë shpresë. Secili që dëshiron të kthehet, duhet të kthehet.

*Mario Maglov,  
Kordinator i Qendrave të Informimit për Komunitete, DPI-UNMIK*

## Danas i Sutra

Revista mujore e UNMIK-ut në gjuhën serbe "Danas i Sutra" (Sot e dje) paraqet ngjarjet më të rëndësishme për komunitetet pakicë të Kosovës. "Danas i Sutra" është produkti kryesor i Qendrave Informative të Komunitetit (QIK), komponent për qasje në komunitet e Divizionit të Informimit Publik. Revista është shpërndarë brenda Kosovës dhe të zhvendosurve që jetojnë në Serbi. Në të gjitha botimet mund të keto qasje, me përmbledhjet e secilës çështje në gjuhën shqipe dhe angleze:

<http://www.unmikonline.org/cic.htm>



"Në momentin që, Përfaqësuesi Special vendosi të veproj kundër Kartës së KB-ve, dukej qartë që qëllimi i tij nuk ishte t'i ndihmonte të dy palët për të arritur zgjidhje me kompromis. Nuk ka asnjë dyshim që Ahtisaari qëllimisht e mbajti njërin anë, atë shqiptare dhe ofroi propozimin që i kënaqte vetëm interesat e palës shqiptare. Fakti që, Serbia në mënyrë unanime e refuzoi planin dhe pala shqiptare në mënyrë unanime e pranoi atë, është dëshmia më e mirë që Serbia e refuzon fuqishëm propozimin e prezantuar nga i Dërguari Special i KB-ve Martti Ahtisaari mbi statusin e Kosovës si një akt i paligjshëm dhe jolegjitim mbi shpërbërjen e shtetit dhe propozon negociata të reja, bazuar në Rezolutën 1244. Kurrë dhe askush nuk do të mund t'ia epte të Dërguarit Special mandatin për shkeljen e parimit të sovranitetit dhe integritetit territorial dhe ndryshimin e kufijve shtetërorë të Serbisë."

*Vojislav Koshtunica, Krye Ministri i Serbisë*



# Shtojca VIII e Pakos së Ahtisarit - Sektori i Sigurisë në Kosovë: Vrojtim nga perspektiva e komisionit për siguri

*Naim Maloku, anëtarë i kryesisë së Kuvendit dhe kryetar i komisionit për siguri, deputet i AAK-së*



Sektori i sigurisë në Kosovë mbetet një ndër sektorët më të ndjeshëm të ndërtimit të demokracisë në Kosovë. Kjo u reflektua edhe në pakon e prezantuar nga presidenti Martti Ahtisaari. Prandaj në gjykimin tim, propozimi i tij është shumë real dhe paraqet situatën e krijuar në Kosovë, si dhe nevojat që duhet përmbushur institucionet e Kosovës në ngritjen e kapaciteteve vetanake në vazhdimin e ngritjes së këtyre institucioneve.

Sektori i sigurisë do të vazhdojë të mbetet një sferë e

mbikëqyrur nga përfaqësuesi civil ndërkombëtarë. Prapë, siç edhe është kërkuar, KFOR-i do të vazhdojë të jetë garantues i sovranitetit dhe sigurisë në Kosovë. Kjo i besohet KFOR-it si vazhdim dhe si institucion që do të bëjë përgatitjen e Forcës së Sigurisë, një forcë 2.500 pjesëtarësh që do të burojë nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) si dhe nga spektri i gjerë publik. Gjithashtu, dispozitat e marrëveshjes parashohin transferimin e ngadalshëm të kompetencave policore tek vendoret dhe ngritjen e shër-

bimit inteligjent. Bashkimi Evropian (BE) do të luaj rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e Policisë, mirëpo, vlen të theksohet se mbikëqyrja e tyre do të jetë më e butë sesa administrimi i deritanishëm i UNMIK-ut me këtë sektorë të sigurisë.

Institucionet kosovare janë duke u zhvilluar, por vlerësoj që ende nuk janë krijuar kushtet për të marrë përsipër më shumë kompetenca në sektorin e sigurisë, kompetenca më të shtuara sesa atyre që na garanton pakoja e Ahtisarit. Në një periudhë 6-7 vjeçare, apo edhe më të shkurtër pasi që kjo sferë ka qenë e mbajtur me kujdes nga UNMIK-u, është e pamjaftueshme për të ngritur institucione të pavarura dhe demokratike të një sektori sensitiv siç edhe është siguria. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e çështjes në fjalë dhe karakteristikave të veçanta të Kosovës, Kosova nuk mund të kalojë në procedurat normale demokratike të ngritjes së kapaciteteve vetanake. Kjo do të ishte shumë e dhimbshme jo vetëm për Kosovën por dhe për rajonin. Prandaj, gjykoj unë, është parë si nevojë nga spektri ndërkombëtar që kjo sferë të vazhdojë në një formë të mbikëqyrjes.

Gjithashtu, fillimet në ngritjen e këtij sektori janë të vështira, ato kërkojnë investime të

mëdha, para të cilat buxheti i varfër i Kosovës nuk mund ti mbulojë, prandaj është i nevojshëm partneriteti me NATO-n dhe BE-në që së bashku ti përballojmë këto sfida. Për më tepër, ngritja e këtyre institucioneve kërkon një konsensus të spektrit politik vendor, qoftë kjo në mes të partive pozitë dhe opozitë apo edhe të spektrit politik ndëretnik, vendosjen e mekanizmave që garantojnë paanshmërinë, funksionimin demokratik, dhe ngritjen e institucioneve përgjegjëse. Gjë të cilën do ta bëjmë në partneritet me miqtë tanë si nga NATO ashtu edhe me BE-në

Mirëpo, ky dokument si çdo dokument tjetër ka edhe sfidat dhe mangësitë e veta në substancë dhe në zbatimin e tij. Në nenin 6 paragrafi 1, pakoja parasheh shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Kjo, gjykoj unë, do të jetë sfidë në radhë të parë për institucionet vendore, e po ashtu edhe për partnerët tanë ndërkombëtarë. Prandaj, kësaj sfide duhet qasur me seriozitet të veçantë dhe një gatishmëri në akomodimin, sidomos të atyre pjesëtarëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet për inkuadrim në forcën e sigurisë. Kjo sfidë, besoj se do të tejkalohet pasi që ligji mbi demobilizimin do të jetë së shpejti në tavolinat e komisionit për siguri, ligj që do të kujdeset sado pak për statusin

e pjesëtarëve të TMK-së.

Sfida e dytë është decentralizimi i policisë dhe kompetencat e zgjeruara të komunave në zgjedhjen e komandantëve policorë. Neni 2.6 parasheh një procedurë që e vendosë Ministrinë e Punëve të Brendshme para një akti të kryer ku komandantet propozohen nga Kuvendi komunal dhe Ministria ka vetëm 15 ditë në dispozicion për zgjedhjen e njërit kandidat, procedurë e cila bëhet vetëm dy herë. Marrë parasysh këtë, ne duhet të caktojmë kritere të barabarta të strukturave komanduese në tërë territorin e Kosovës, gjë të cilën nuk e parasheh pakoja e Ahtisarit.

Nga ana tjetër, pakoja e Ahtisarit, gjithashtu, në kuadër të rregullimit të sektorit të sigurisë, ka shtuar volumin e punës së komisionit parlamentar për siguri. Nga 17 ligje që me pakon e Ahtisarit (pakoja e dërguar në Këshill të Sigurimit) parashihej të aprovohej gjatë dhe pas periudhës së tranzicionit, afërsisht gjysma do të jenë në kompetencë e komisionit për siguri. Kjo i ka vënë komisionit një barrë të madhe, të përnjëhershme, legjislative. Mirëpo, komisioni është përgatitur për një sfidë të tillë duke bashkëpunuar me partnerë si ndërkombëtarë ashtu edhe vendorë.

Prandaj, me plotë besim mundë të them se si nga aspekti substancial i Shtojcës VIII të pakos ashtu edhe nga aspekti procedural, kjo është reflektim i realitetit të krijuar në Kosovë dhe paraqitje e sfidave që Kosova do të ballafaqohet në të ardhmen në sektorin e sigurisë.

## Parlamenti Evropian mbështetë raportin mbi Kosovën

Më 29 mars të vitit 2007, Parlamenti Evropian ka mbështetur plotësisht pakon e Ahtisaarit për zgjedhjen e statusit, duke deklaruar se "mbikëqyrja e sovranitetit nga ndërkombëtarët është opsioni më i mirë" për të siguruar qëllimet për një Kosovë paqësore dhe vet-qeverisëse. Raporti gjithashtu rikonfirmon perspektivën evropiane për Serbinë dhe Kosovën, dhe apelon tek BE që të luajnë rolin kryesor në negociatat e tanishme ndërkombëtare për zgjidhjen e statusit.

Raporti me iniciativë e Joost Lagendijk (Të Gjelbrit/EFA, NL), është miratuar në seancën plenare të Parlamentit Evropian me shumicë votash (490 për, dhe 80 kundër, dhe me 87 të abstenuar). Në raport thuhet se zgjidhja duhet të sigurojë: qasje në organizatat ndërkombëtare financiare; prezencë ndërkombëtare në Kosovo/Kosovë, me përcaktim të qartë të rolit dhe mandatit të saj; dispozita të qarta për decentralizimin i cili garanton autonomi substancial në lëmitë kryesore; respektimin

e plotë të të drejtave të njeriut; ruajtjen e karakterit shumë-etnik të Kosovës, me mbrojtjen e objekteve kulturore dhe fetare; themelimin e një Force të Sigurisë së brendshme, shumë-etnike dhe të kufizuar; dhe garancitë ndërkombëtare për integritetin e të gjitha shteteve fqinje.

Për shmangur shqetësimet që çdo formë e pavarësisë për Kosovën do të acaronte tensionet tjerë separatiste, raporti "thekson se zgjidhja për Kosovën nuk do të paraqesë presedan në të drejtën ndërkombëtare, pasi që Kosova ka qenë nën udhëheqjen e Kombeve të Bashkuara që nga viti 1999 [...dhe] në asnjë mënyrë nuk mund të krahasohet me situata të konfliktit në rajonet tjera që nuk janë nën udhëheqjen e administratës së OKB." Krahas kësaj, Parlamenti tha se "në të ardhmen zgjidhja për statusin e Kosovës bazohet edhe në faktin që si Serbia ashtu edhe Kosova/Kosovo janë në rrugë për t'u bërë pjesë e UE, së bashku me fqinjët e tyre, pasi që e ardhmja e Ballkanit Perëndimor gjendet në Bashkimin Evropian."

Raporti gjithashtu thekson që shtetet anëtare të UE duhet të flasin me një zë sa i përket çështjes së Kosovës, duke miratuar qëndrimet e përbashkëta në Këshill dhe duke e mbajtur atë qëndrim në nivelin ndërkombëtar, posaçërisht në Këshillin e Sigurisë së Kombeve të Bashkuara. Raporti gjithashtu paraqet edhe përkrahjen për themelimin e Misionit të Sigurisë Evropiane dhe Politikës Mbrojtëse për Kosovën.

Komisari për Zgjerim Evropian Olli Rehn e kishte mirëpritur raportin dhe i kishte përgëzuar raportuesit dhe anëtarët për punën e tyre intensive për raport.

Doris Pack, Kryesuesja e Delegacionit të Parlamentit Evropian për Evropën Jug-Lindore, e kishte mirëpritur "pa asnjë rezervë" votimin dhe përkrahjen për "një pavarësi të mbikëqyrur" për Kosovën. Ajo kishte thënë se "nuk ekziston asnjë mënyrë tjetër e mundshme për zgjidhje paqësore".



## BE-ja do të ketë rol udhëheqës në Kosovë

Raporti dhe propozimi i të Dërguarit Special të KB-së Presidentit Ahtisari u dorëzuan në Këshillin e Sigurimit më 26 mars 2007. Unë i bashkëngjitëm Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së dhe Presidencës së BE-së në përkrahjen e raportit dhe propozimit të paraqitur nga Presidenti Ahtisaari.

Unë besoj që të gjithë pajtohemi që në një botë ideale dyja palët do të gjenin një kompromis mes vete. Gjatë 14 muajve të shkuar të negociatave, u gjet një lloj pajtimi në disa aspekte praktike të zgjidhjes. Fatkeqësisht, Beogradi dhe Prishtina, ende mbeten diametralisht të kundërt mbi çështjen thelbësore të statusit.

Propozimi i Presidentit Ahtisarit është i përpiluar me qëllim që të zhvillojë ndërtimin e shoqërisë multi-etnike në Kosovë, në bazë të sundimit të ligjit. Ai përmban një spektër të gjërë dispozitash, të cilat synojnë të sigurojnë të ardhmen e gjitha komuniteteve në Kosovë. Ai vë bazën për zhvillim ekonomik dhe stabilitet politik në Kosovë, gjë që do të kontribuonte edhe në rritjen e stabilitetit rajonal.

Esenca e vendimit mbi Kosovën është uniteti evropian. Ne duhet të vazhdojmë të mbështesin Presidentin Ahtisari dhe propozimin e tij, me përkushtim të qëndrueshëm në Këshillin e Sigurimit të KB-së. Nuk ka kurrfarë dobie në vonimin e këtij vendimi. KB-ja ka udhëhequr Kosovën për 8 vite. Status quo-ja nuk është më e qëndrueshme.

Procesi i statusit ka arritur tani një fazë vendimtare. Unë pres që Këshilli i Sigurimit të qëndrojë me përgjegjësitë e tij në frymën e multi-lateralizmit të përgjithshëm, si dhe të çojë



procesin drejt një përfundimi të hershëm dhe të suksesshëm.

Posa të jetë zgjidhur çështja e statusit, do të fillojë faza e implementimit. Faza do të ketë sfidat e veta. Edhe këtu, BE-ja duhet të ketë unitet dhe të jetë e bashkuar.

BE-ja do të ketë rol udhëheqës në udhëheqjen e misioneve ndërkombëtare civile dhe në mbështetjen e perspektivës evropiane për Kosovën. Kjo do të kërkojë vendosjen e të gjitha mekanizmave tonë si dhe ofrimin e resurseve të konsiderueshme. Ne kemi vetëm strategji për t'u vendosur dhe jo për t'braktisur

Më lejoni të jem i qartë: pronësia vendore dhe partneriteti me bashkësinë ndërkombëtare janë çelësi i implementimit të suksesshëm të statusit.

BE-ja dhe partnerët e tij ndërkombëtarë nuk mund të bëjnë dhe as t'a zëvendësojnë punën që Kosova duhet bërë, as në kuptimin e vullnetit politik, e as në atë të resurseve. Por, ne mund të ndihmojmë.

Zgjidhja e statusit nuk vjen falas.

Nevojat financiare të Kosovës nuk janë bërë ende të njohura plotësisht. Por, vlerësimet e hershme tregojnë që mund të kërkohej një ndihmë me grante ndërkombëtare prej 1.3 - 1.5 miliardë € për 3 vitet e para pas statusit.

Do të kemi katër fusha kryesore të mbulojmë:

- Pjesën kosovare të borxhit jugosllav,
- Koston e zbatimit të statusit
- Nevojat e zhvillimit ekonomik; si dhe
- Koston e pranisë ndërkombëtare, duke përfshirë misionin e planifikuar të ESDP-së, i cili pritet të jetë misioni më i madh civil i menaxhimit të krizave që është ndërmarrë ndonjëherë nga BE-ja. Prania e përgjithshme e BE-së në Kosovë duket të jetë rreth 1500-2000 punëtorë ndërkombëtarë.

Të gjithë ne e dimë që Bashkimi Evropian ballafaqohet me sfida të rëndësishme të politikës së

jashtme në arenat tjera, duke përfshirë Lindjen e Mesme, Afganistanin, dhe Darfurin. Kosova nuk është prioriteti i vetëm i financimit.

Por, Evropa ka përgjegjësi të veçantë në Kosovë, e cila gjendet pranë nesh. BE-ja duhet të vazhdojë me mjetet e tij që të mbështesë politikat dhe të çojë procesin përpara.

Në takimin e Ministrave të Jashtëm të BE-së në Gymnich më 30 mars 2007, unë do të theksoj që resurset nuk mund të vijnë vetëm nga buxheti i BE-së. Shtetet anëtare dhe partnerët tanë të bashkësisë ndërkombëtare duhet të marrin përgjegjësitë e tyre..

Komisioni do të përmbledhë një pako financiare cila reflekton shkallën e përgjegjësisë sonë. Unë llogaris në mbështetjen tuaj për këtë.

Dhe në fund disa fjalë për Serbinë. Më lejoni t'ju siguroj që BE-ja mbetet plotësisht e përkushtuar ndaj perspektivës evropiane të Serbisë. Ne jemi të gatshëm të punojmë me qeverinë e re drejt këtij qëllimi. Tani, i mbetet qeverisë së re të Serbisë të plotësojë kushtet për rifillimin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit.

Angazhimi shtuar me Serbinë është thelbësor për të çuar procesin e statusit drejt një përfundimit të suksesshëm. Një Serbi që ka besim në të ardhmen e saj evropiane do të ndihmohet për të kapërcyer të kaluarën.

*Fjalimi i Komisionerit të Zgjerimit, Olli Rehn, mbi të ardhmen e Kosovës dhe rolin të Bashkimit Evropian në Parlamentin Evropian më 20 mars 2007.*



# Kosovës i duhet angazhimi ndërkombëtar

Torbjorn Sohlstrom, Udhëheqës i Ekipit Përgatitor për Zyrën Civile Ndërkombëtare / Përfaqësues Special i BE-së (ZCN/PSBE)

Bashkësia ndërkombëtare, në dy dekadat e fundit ka qenë e angazhuar në Evropën qendrore dhe atë lindore për t'i ndihmuar ato vende që do t'i bashkohen Bashkimit Evropian. Si Bashkim Evropian, ne jemi duke u angazhuar mjaft shumë në tërë Ballkanin, duke e ndihmuar rajonin që realizojë perspektivën Evropiane. Andaj, për mua është e qartë se BE-ja dhe partnerët e saj do të angazhohen në Kosovë, madje edhe pas zgjidhjes së statusit, deri në kohën kur Kosova, shpresojmë, të bëhet pjesë e rrjedhës Evropiane, pjesë e konstruksionit Evropian dhe eventualisht pjesë e Bashkimit Evropian.

Kur flasim mbi angazhimin e ardhshëm ndërkombëtar, mendojmë për dy gjëra. Njëra është lloji i angazhimit që BE-ja do të ketë në të gjitha pjesët e këtij rajoni – duke përkrahur reformat strukturore, duke ndihmuar në harmonizimin me standardet e BE-së, dhe angazhimi politik. Këto sigurisht që edhe do të bëhen. Por këtu kemi edhe një gjë tjetër. Gjithashtu do të jetë edhe një prani e re ndërkombëtare, e caktuar për Kosovën në mënyrë specifike dhe do të ketë mandat, sipas marrëveshjes së statusit, që t'i ndihmojë Kosovës t'i tejkalojë disa sfida specifike gjatë një periudhë të kufizuar kohore. Angazhimet e posaçme do të përqendrohen në dy fusha; e para do të përfshijë elementet kyçe të marrëveshjes së statusit dhe e dyta do të jetë fusha e sundimit të ligjit.

Angazhimi i ardhshëm ndërkombëtar përbëhet nga pesë komponentë: Zyra Civile Ndërkombëtare (ZCN) me



rol kyç në mbikëqyrjen e implementimit të marrëveshjes së statusit; misioni i Bashkimit Evropian në fushën e sundimit të ligjit; misioni i OSBE-së me theks të veçantë në zhvillimet nëpër komuna, përmes pranisë së saj në terren; prania e vazhduar ndërkombëtare e siguruar nga NATO; dhe së fundi, ndoshta me më së shumti rëndësi, përpjekja madhore e ngritjes së kapaciteteve nga e tërë bashkësia ndërkombëtare me Komisionin Evropian, Bankën Botërore, UNDP-në dhe donatorët bilateral, në role udhëheqëse. Për sa i përket BE-së, ne, së bashku me Bankën Botërore, jemi duke përgatitur një konferencë të donatorëve që do të ngjajë pak kohë pas përfundimit të procesit të statusit dhe ne shpresojmë se së bashku me partnerët tanë mund të bëjmë përpjekje për të ndihmuar Kosovën në një periudhë vendimtare. Ju

mund të jeni të vetëdijshëm se rishtas, Komisioni Evropian ka ndarë 190 milion euro për tre vitet e para, si pjesë e programit të asistencës së BE-së për Ballkanin Perëndimor, i quajtur Instrumentet për programin e para-anëtarësimit. Duke siguruar një shumë të tillë, Komisioni Evropian do të ofrojë më shumë ndihmë për kokë banori në Kosovë sesa në cilindo vend tjetër në botë dhe unë mendoj se kjo është shenjë e vullnetit tonë për të ndihmuar Kosovën.

Është e qartë për ne se zgjidhja e statusit do të sjellë mjaft përgjegjësi dhe detyra të reja për institucionet e Kosovës. Prania e ardhshme ndërkombëtare nuk është organizatë pasardhëse e UNMIK-ut. Pasardhës të UNMIK-ut do të jenë institucionet e Kosovës. Kjo, gjithsesi, do të jetë një sfidë më e madhe politike, administrative

dhe ekonomike, nga të gjitha ato me të cilat këto institucione janë marrë më parë. Përgjegjësi për drejtimin e marrëdhënieve të Kosovës më nuk do të qëndrojë tek bashkësia ndërkombëtare. Ne besojmë se kjo është një sfidë aq e madhe sa që e tërë shoqëria e Kosovës, dhe veçanërisht institucionet e saj, duhet të përgatiten jashtëzakonisht mirë për të dhe të punojnë shumë në përgatitje tani, sepse ne të gjithë dëshirojmë që Kosova të kalojë testin e saj të parë pas-statusor.

Se sa gjatë do të qëndrojë ZCN në Kosovë varet nga mënyra sesi Kosova do t'i menaxhojë këto sfida të ardhshme. Natyrisht, nëse kemi implementim të rregullte dhe të shpejtë të marrëveshjes së statusit, bashkësia ndërkombëtare nuk ka nevojë të qëndrojë këtu shumë gjatë. Nëse ka më shumë vështirësi në procesin e implementimit dhe reforma të ngadalshme, forma speciale e angazhimit ndërkombëtar do të duhet të qëndrojë këtu më gjatë. Por përsëri, natyra e përfshirjes ndërkombëtare do të varet nga kapaciteti i institucioneve të Kosovës. Ne gjithsesi se nuk dëshirojmë që bashkësia ndërkombëtare të ketë përgjegjësi në Kosovë, përtej atyre që janë absolutisht të nevojshme. Ne dëshirojmë që Kosova t'i menaxhojë vet marrëdhëniet e veta dhe që këtë gjë t'a bëjë si duhet, për të lëvizur mëpastaj drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

*Artikulli është marrë nga intervista e botuar në 'Kosova në Fokus', Nr. 30, shkurt 2007.*

# BE-ja mbështetë ndërtimin e së ardhmes së Kosovës

Eugen Wollfarth, Kryesues i Misionit Ndërlidhës Gjerman



Sekretari i Përgjithshëm i KBeve Ban Ki Moon prezantoi para Këshillit të Sigurimit, Propozimin Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës më 26 mars 2007. Ky prezantim shoqërohej me ku thuhej që ai “e mbështetë plotësisht” propozimin e të Dërguarit Special Martti Ahtisaarit dhe rekomandimin e tij, që “Statusi i Kosovës duhet të jetë pavarësi e mbikëqyrur nga bashkësia ndërkombëtare”. BE-ja dhe Grupi i Kontaktit kanë qënë unik për propozimin e Ahtisaarit gjatë tërë procesit, dhe më 26 mars 2007, kryesuesja e BE-së Gjermania, ka shprehur mbështetjen e fortë për propozimin si dhe shpresën e saj, që Këshilli i Sigurimit do të “miratojë propozimin në kohën e duhur”. Që nga viti 2006, vendet anëtare të BE-së janë duke u përgatitur për një mision të BE-së, i cili ka për qëllim të ndihmojë Kosovën pas vendimit për statusin. BE-ja

planifikon të vendosë misionin e Sigurisë Evropiane dhe Politikat për Mbrojtje që do të përqëndrohet në çështjet lidhur me sundimin e ligjit: vendet anëtare të BE-së pastaj do t’u ofrojnë institucionet e Kosovës me gjykatës, policë, ekspertë në drejtësi, doganë, dhe çështje të sigurisë.

Sipas mendimit tonë propozimi gjithpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, është një dokument i balancuar, i cili do të kontribuojë drejtë së ardhmes stabile dhe prosperuese për Kosovën, ku të gjithë qytetarët, pavarësisht nga gjuha e tyre amtare, do të jenë në gjendje të jetojnë në paqe dhe të kuptojnë potencialet e tyre personale. E kam pohuar vazhdimisht në shumë raste, që zgjedhja e statusit, e përgatitur me shumë kujdes nga Martti Ahtisaari është një opcion ku fitojnë të gjitha palët e involvuara.

Shikoni decentralizimin: sistemi i decentralizuar hap dyert për pjesëmarrje më të drejtëdrejtë të qytetarit në vendimarrje politike, dhe sëkëndejmi edhe për një sistem të zhvilluar të demokracisë. Gjithnjë konsiderohet si një “temë e nxehtë”, meqë është aq afër me jetën e përditshme të njerëzve. Qeveritë qendrore ndonjëherë frikohen nga humbja e kontrollit dhe këto qeveri shpeshherë hezitojnë të përballen me detyrat e reja, veçanërisht, për faktin që ato shpeshherë kanë resurse jo adekuate njerëzore dhe financiare për të arritur rezultate të mira. Në Kosovë, bashkësia ndërkombëtare do të mbështesë qeverinë qendrore dhe lokale për të përmbushur reformat të cilat kryesisht synojnë bashkëpunimin në mënyrë më efikase dhe të krijojnë mundësi që të dëgjohen më lehtë zërat e qytetarëve në gjuhët e tyre, përmes institucioneve që ata u besojnë.

Ose shikoni të drejtat e komunitetit: të gjitha komunitetet përfitojnë kur fuqizohen të drejtat e komunitetit, siç është e drejta për të qenë i përfaqësuar në mënyrë adekuate dhe pjesëmarrja në proceset politike; e drejta e përdorimit të gjuhës amtare në jetën publike dhe e drejta për t’u shkolluar në gjuhën amtare. Është fakt që popullata e Kosovës është shumetnike dhe ky është një thesar i jashtëzakonshëm. BE-ja me përbërjen e saj shumë etnike dhe shumë kulturore është tërësisht përkushtuar në inkurajimin e diversitetit të qëndrueshëm kulturor. Kosova posedon trashëgimi unike kulturore dhe fetare, e cila si rezultat i shumë ndikimeve të ndry-

shme është kultivuar dhe zhvilluar me shekuj. Kjo trashëgimi e shumëfishtë, e cila është tërësisht kosovare, por dhe europiane, duhet ruajtur.

Procesi i integritimit në BE do të thotë që Kosova duhet të punojë shumë, në mënyrë që të adoptojë sistemin e saj ligjor në përputhje e standardet e BE-së. Por, ideja europiane ngërthen në vete edhe më shumë se kaq: është objektivë ambicioze dhe aspiratë për ata të cilët jetojnë në Kosovë. Kohëve të fundit kemi festuar 50 vjetorin e BE-së. Pesëdhjetë vitet e fundit ishin tregim shumë i suksesshëm duke shënuar transformimin e kontinentit Europian si rezultat i zgjerimit të BE-së nga gjashtë vende anëtare deri në 27 sish. Ky proces i zgjerimit, i cili bën kontinentin tonë më paqësorë dhe më të prosperuar duhet dhe me siguri se do të vazhdoj.

Gëzohem të shoh që, edhe qeveria dhe shumica dërmuese e popullatës së Kosovës janë të vetëdijshëm që e ardhmja e Kosovës gjendet në Evropë. Siç është konfirmuar me Samitin e Selanikut në qershor të vitit 2003, dhe mbledhjet pasuese të Këshillit Europian, “integrimi i ardhshëm në strukturat Europiane dhe anëtarësimi përfundimtar në Bashkësinë [e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën] është prioritet kryesor i BE-së”:

“Ballkani do të jetë pjesë integrale e Evropës së bashkuar. ... BE-ja thekson që ritmi për lëvizjen e mëtutjeshme të vendeve të Ballkanit Perëndimor drejtë BE-së është në duart e veta dhe do të varet nga performanca e çdo shteti në zbatimin e reformave duke respektuar kështu kri-

teret e përcaktuara nga Këshilli European i Kopenhagës në vitit 1993 dhe kushtet e PSA-së.” (Rendi i Ditës së Selanikut për Ballkanin Perëndimor, 2003)

Kosova është duke ecur mirë në Procesin e Stabilizim-Asocimit përmes Mekanizmit Përcjellës. Për Stabilizim dhe Asociim. Plani i veprimit për zbatimin e Partneritetit Evropian, i cili është miratuar nga Qeveria e Kosovës në gusht të vitit 2006, e ndihmon qeverinë të koordinojë punën e vet drejt integritimit evropian dhe ë t’u shpjegoj qytetarëve se çfarë nënkupton integrimi evropian.

Është shënuar përparim i madh në sferën e administratës publike dhe reformave ekonomike. Nevojitet të bëhet më shumë në fushën e drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave, megjithatë kjo do të bëhet me ndihmën e BE-së, e cila do t’i ndihmojë Kosovës, siç edhe i ka qëndruar gjatë viteve të kaluara. BE-ja do t’a ndihmojë Kosovën, përmes misionit më të madh për Siguri dhe Politika për Mbrojtje të Evropës (ESDP) deri tani, përmes ve individëve ekspertë nga vendet anëtare të BE-së, si dhe përmes asistencës financiare. BE-ja gjithashtu do të vazhdojë të jetë donatori më i madh për Kosovën; mbështetja financiare përmes Instrumentit për Para-Anëtarësim, 2007 deri në 2009, e që kapin shumat deri 194,2 milion euro kokë njeriu, që paraqet shumën më të madhe sesa në çdo rajon tjetër.

Kosova ka hyrë në fazën vendimtare. Javët dhe muajt që po vijjnë nuk do të jenë të lehta. Përgatitja e Kosovës për të ardhmen, vazhdon të jetë detyrë e rëndë dhe fisnike, por jam i sigurt që kosovarët dhe qeveria e tyre janë të gatshëm t’a bëjnë Kosovën vend më të mirë dhe më të sigurt për të gjithë.

## Deputetët me “duar të lidhura”

*Bul Salihu, Shef i Zyrës së TV Alsat në Prishtinë*

Deputetët e Kuvendit të Kosovës gjatë procesit katërmbëdhjetë mujor të negociatave në mes Prishtinës dhe Beogradit nën ndërmjetësimin ndërkombëtarë nuk kanë qenë pothuajse fare të përfshirë në këtë proces dhe vetën më tepër e parë si lojtarë rezervë në derbin historik që është zhvilluar në Vjenë të Austrisë.

Njëri prej tyre është edhe anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Sabri Hamiti, i cili kritikon Ekipin Negociator që sipas tij ka pasur paraqitje zemërgjerë qysh në nisje të negociatave.

“Ekipin e Kosovës e obligonte një rezolutë e Kuvendit të Kosovës, që të mos negocionte statusin e Kosovës me Beogradin. Në anën tjetër diplomati i shquar Ahtisaari, me një finesë diplomatike, duke shpallur se po bisedohej vetëm për fusha të veçanta të organizimit të jetës, dalëngadalë ka krijuar rrjetin institucional që mbrendashkruan një status për Kosovën”, pohon Hamiti, në një intervistë për ASI.

Edhe kolegu i tij në Kryesinë e Kuvendit nga Partia Demokratike e Kosovës, Xhavit Haliti pranon se roli i Kuvendit në bisedimet për të ardhmen e Kosovës ka qenë i vogël.

“Grupi Negociator i ka dhënë vetës kompetenca më shumë sesa që ka marrë nga Kuvendi, kur është miratuar si Ekip. Në një mënyrë ose tjetër e ka spostuar vendimmarrjen nga Kuvendi i Kosovës”, thekson Haliti.

As Hamiti e as Haliti nuk janë përfshirë drejtpërdrejtë në bisedimet e Vjenës, ku pesë

anëtarët e Ekipit Negociator më tepër kanë preferuar që të dërgojnë njerëzit nga partitë e tyre.

Të dy deputetë, njëri i pozitës e tjetër i opozitës ndajnë të njëjtin mendim për bisedimet e zhvilluara në Vjenë për të ardhmen e vendit—se Kuvendi është lënë anash.



Sabri Hamiti:  
Ekipi Negociator e kuptoj me  
vonesë finesën  
diplomatike të Ahtisaarit...

*Pyetje: Z. Hamiti, si e vlerësoni procesin negociatave që është zhvilluar për 14 muaj në Vjenë të Austrisë?*

Sabri Hamiti: Procesi i negociatave, sa i përket Kosovës, tanimë ka mbaruar. Mbas kalimit të Propozimit të Ahtisarit në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, mundësia e ndikimit të Ekipit të Kosovës në rrjedhat e mëtejme është fare i vogël. Por, tani mund të flitete për një histori njëjvecare të negociatave.

Ekipin e Kosovës e obligonte një rezolutë e Kuvendit të Kosovës, që të mos negocionte statusin e Kosovës me Beogradin. Në anën tjetër diplomati i shquar Ahtisari, me një finesë diplomatike, duke shpallur se po bisedohej vetëm për fusha të veçanta të organizimit të jetës, dalëngadalë ka krijuar rrjetin institucional që mbrendashkruan një status për Kosovën. Këtë e ka kapur e kuptuar pak me vonesë Ekipi i Kosovës. Jo vetëm se ka pasur një paraqitje zemërgjerë, që në fillime, por se bisedimet kryesisht janë përqendruar në statusin e minoriteteve në Kosovë, kryesisht në statusin e minoritetit serb. Këtë e dëshmon edhe teksti final i Pakos së Ahtisarit që tashmë është në Këshillin e Sigurimit.

Kompromiset janë bërë për të drejta të veçanta për minoritetin serb, të sistemuara nëpërmjet konceptit të “decentralizimit”, të zonave të mbrojtura e të financimit të komunave me shumicë serbe. Kjo zgjidhje e përmban rrezikun që të drejtat e veçanta, të strukturohen ngadalë në një nivel të tretë pushtetar, duke ngritur tensione me shumicën e me pakicat e tjera.

Ekipi i Kosovës ngulmon gjithnjë që kompromiset janë bërë për të krijuar Kosovën e pavarur e sovranë në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare, e cila do të jetë këtu e instaluar në trajtën e mbikëqyrësit, në formacion të Bashkimit Evropian, madje me fuqi të ndërhyrjes në fazën e parë të implementimit.

Kosova e pavarur me sovranitet të kufizuar (mbikëqyrrur), ky është propozimi i Ahtisarit.



**Pyetje: A është dashur që Kuvendi të ketë një rol më të madh në këto negociata?**

Sabri Hamiti: Skema apo struktura fillestare e ekipit negociator të Kosovës, e propozuar nga ish presidenti Rugova dhe e kaluar në Parlament, ka qenë e tillë që ka synuar më tepër një unitet të përfaqësimit qytetar se sa të përfaqësimit institucional. Kjo tendencë me kohë është forcuar, kështu që ekipi negociator e ka zgjeruar rrjetin e vet të funksionimit e të krijimit të trupave punuese më tepër nëpërmjet përfaqësimeve partiake se sa të përfaqësimeve institucionale.

Pra, në këtë rrjedhë e logjikë të ndodhive, Kuvendi ka ngelur në nivelin e mandatuesit të Ekipit, pa një dinamikë në pjesëmarrje në negociata. Kuvendi ka aktivizuar më tepër kah fundi, duke kërkuar më tepër raporte të Ekipit apo dhe në diskutimin përfundimtar shterrues të propozimit të Ahtisarit, atëherë kur ishte njëmend vonë. Një provë më të hershme të kërimit të raporteve e ka bërë Komisioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar e Integriteteve Euroatlantike i Kuvendit, në mënyrë të vacantë për çështjen e decentralizimit.

Pra, tani po flasim për një proces të mbaruar. Kuvendi është dashur të ketë rol më të madh në këtë proces, në proporcion me përgjegjësitë e tij.

**Pyetje: Si e vlerësoni mospërfilljen e Kuvendit në bartjen e kompetencave nga UNMIK-ut në IPVQ?**

Sabri Hamiti: Mospërfillja e Kuvendit në procesin e bartjes së kompetencave është një gabim. Qoftë kjo e bërë nga përpjekja e Ekipit Negociator dhe i rrjetit të tij që të instalohet në një funksion të ndërmjetmë apo dicka tjetër, kjo mënyrë e veprimt, dashur a padashur,

shpie kah procesi i dobësimit të institucioneve, për të most thënë deinstitutionalizimi. Ekipi për bartjen e kompetencave është dashur të propozohet nga Qeveria e të marrë miratimin në Kuvend.

Kuvendi i Kosovës është organi më ilartë përfaqësues i vendit, ai është mandatar i Qeverisë dhe i Ekipit Negociator, ai është vlerësues i punës së tyre e jo shërbëtor i tyre. Më në fund, është ai që krijon unitetin e përfaqësimit qytetar, formulë që artikullohet me ëndje nga përfaqësues të ndryshëm politikë në Kosovë.

**Pyetje: A është i përgatitur dhe a ka kapacitete Kuvendi të miratojë të gjitha ligjet që dalin nga Pakoja e Ahtisarit?**

Sabri Hamiti: Së pari, Pakoja e Ahtisarit është vepër e kryer vetëm pasi të votohet në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

Së dyti, Kuvendi mund ta implementojë këtë pako mbasi të jetë shpallur e njohur pavarësia e Kosovës.

Së treti, Kuvendi e ka detyrë dhe përgjegjësi kushtetuese e historike që të krijojë pakon e ligjeve bazike sistemore të shtetit të ri, duke nisur nga ligji themelor, Kushtetuta e Kosovës.

Këtu nuk mund të flitet për përgatitje e kapacitetete. Kuvendi duhet të marrë gjithë fuqitë e veta në këtë punë duke përfshirë në procesin e madh legjislativ komisionet, grupet parlamentare duke përfshirë dhe konsulencë të fuqishme e intensive të ekspertëve e të shoqërisë civile, duke përfshirë edhe konsulencën ndërkombëtare që ka qenë e dobishme gjatë gjithë këtyre viteve në punën legjislativë të Kuvendit.

Pra. Kuvendi i Kosovës është i gatshëm të mabrojë punën e e presin për ndërtimin e shtetit të pavarur të Kosovës.



**Xhavit Haliti:** Grupi Negociator i ka dhënë vetës kompetenca më shumë sesa që ka marrë nga Kuvendi

**Pyetje: Z. Haliti, si e vlerësoni procesin e tashëm të negociatave?**

Xhavit Haliti: Procesi është zhvilluar në kushtet që dihen. Kuvendi përveç që ka votuar për Ekipin Negociator, përfshirja e tij në bisedime ka qenë e kufizuar.

Ka munguar gjatë këtij procesi komunikimi i përhershëm me opinionin përmes Kuvendit.

Tani a jemi të kënaqur apo jo? Meqë rezultati është pozitiv, besoj se të gjithë janë të kënaqur, pavarësisht nga puna e Ekipit Negociator.

**Pyetje: A është dashur që Kuvendi të jetë më shumë i përfshirë në këto negociata, të ketë një rol më të madh?**

Xhavit Haliti: Mendoj se në Kuvend të paktën është dashur që të debatohet për disa çështje. Në veçanti është dashur të debatohet për decentralizimin,

për ristrukturimin ose më mirë të themi krijimin e një force të re mbrojtëse të Kosovës, pas shkrirjes së TMK-së. Mediumet ndonjëherë kanë krijuar me apo pa qëllim huti dhe paqartësi tek opinioni se çfarë do të ndodh me territoret e ridefinuara të komunave të reja, marrja e territoreve komunave ekzistuese dhe delegimi i tyre komunave të reja, që është quajtur ndarje territoriale e Kosovës. Pra, lloj-lloj gjërash kanë kaluar dhe kanë mbetur nën mëshirën e trajtimit të medimeve dhe nuk janë trajtuar drejtpërsëdrejti para opinionit përmes Kuvendit të Kosovës dhe kjo ka ndikuar që shqetësimet tek qytetarët të jenë të asaj përmase që kemi parë të gjithë ne dhe realisht kanë ndikuar tek njerëzit që të mendojnë se çfarë në të vërtetë është duke bërë Kuvendi i Kosovës.

**Pyetje: Sipas kësaj që thoni ju, Kuvendi ka mbetur jashtë tavolinës së bisedimeve të zhvilluara për statusin, ku ka munguar edhe komunikimi në mes ligjvënësit dhe Ekipit Negociator ?**

Xhavit Haliti: Grupi Negociator i ka dhënë vetës kompetenca më shumë sesa që ka marrë nga Kuvendi, kur është miratuar si Ekip. Në një mënyrë ose tjetër e ka spostuar vendimmarrjen nga Kuvendi i Kosovës. Asnjë autorizim qoftë për krijimin e grupeve që kanë marrë pjesë në bisedime, për zgjedhjen dhe miratimin e tyre nuk e kanë kaluar përmes Kuvendit, përmes Kuvendit nuk ka kaluar as buxheti që është shpenzuar nga Grupi Negociator. Përmes Kuvendi nuk ka kaluar asnjë emër tjetër përveç anëtarëve të Ekipit Negociator. Të gjitha këto vendime janë marrë përmes



një konsensusi politik nga partitë politike, nga grupet parlamentare, e më tepër nga udhëheqësit e partive politike, të cilët vetë kanë zgjedhur njerëzit për këto grupe. Ky është një realitet.

***Pyetje:** Ndërkohë që krahas bisedimeve, Kuvendi ka mbetur i përjashtuar edhe nga procesi i bartjes së kompetencave nga administrata ndërkombëtare tek institucionet e Kosovës. Asnjë nga komisionet e fushave përkatëse të Kuvendit nuk është përfshirë në grupet për bartjen e kompetencave me çka janë marrë ekskluzivisht njerëzit e emëruar nga Qeveria Çeku?*

Xhavit Haliti: Kjo është një çështje në vete. Pasi që qeveria e ka "kuletën" – parat – është krijuar një hapësirë edhe për keqpërdorimin e buxhetit të Kosovës, duke iu dhënë mundësinë individëve të caktuar që të emërojnë, shkarkojnë, të krijojnë grupe të ndryshme dhe këto grupe të mos kenë përgjegjësi për asgjë, as institucionale e as për shpenzimet e

bëra, as për vendimet e marra. Kjo nuk do të lejohej në asnjë vend të botës. Në Kosovë është ndjekur një praktikë e gabuar dhe e pranuar gabimisht, siç është rasti i emërimit të Bordeve të caktuara të cilat nuk i japin llogari asnjëherë Kuvendit. E kemi, për shembull tani privatizimin e telefonisë mobile, për çka Kuvendi as që është pyetur, as që ka marrë ndonjë vendim, as që ka pasur të bëjë me ato komisione dhe as që është debatuar ndonjëherë në atë instancë të Kuvendit lidhur me privatizimin e tenderit të telefonisë mobile.

Sa i përket kësaj që thoni ju, mund të them se është një praktikë e instaluar mbrapshtë nga e kaluara dhe e pranuar ndoshta për arsye të caktuara meskine të shefave ose kryeshefave të institucioneve për t'i kaluar problemet më lehtë, për të gjetur mundësi për t'i mbuluar shpenzimet e paarsyetuara të buxhetit të Kosovës si dhe për t'i fshehur informatat jo vetëm nga opinioni dhe qytetarët por edhe

nga vetë deputetët duke mos ju dhënë shansin që të debatohet për këto çështje.

Tani si dhe pse është ndërtuar kjo, kush e ka ndërtuar këtë mekanizëm dhe pse e kanë pranuar deputetët do të thosha se është një çështje për të cilën duhet të cilës duhet t'i kushtohet vëmendje e posaçme. Kemi edhe gjëra të pakëndshme të grupet parlamentare. Për shembull shefi i një grupi parlamentar ngritët dhe thotë se "grupi ynë politik", duke harruar që është në Kuvend e që përpara ka deputetët e jo anëtarët e partisë. Politika bëhet në parti e jo në Kuvend, politikat ndërtohen në qeveri dhe ato pastaj miratohen në Parlament. Por disa kanë dëshirë që ta shohin vetën mbi institucione.

Ne e kemi rregulloren e Kuvendit të Kosovës e cila është një përzierje -- idesh dhe rregulloresh të vendeve të ndryshme -- të përshtatura për interesa të caktuara të ndonjë grupi apo individ. Nuk jemi përcaktuar që ta marrim një kopje origji-

nale të një parlamenti të caktuar. Për shembull, praktika e funksionimit të Kuvendit të Kosovës është praktika gjermane e funksionimit të Kuvendit. Pse të mos përcaktohemi për rregulloren e tyre. Të gjitha problemet e ngritura, të gjitha shqetësimet e ngritura janë të zgjidhshme përmes rregullave. Ne kemi lënë hapësirë për interpretimin e rregulloreve siç duam, kemi lënë hapësirë që ta përdorim buxhetin sipas qejfit.

***Pyetje:** Pse keni heshur ju si opozitë por edhe si deputetë për këto q] thonë? A ka qenë kjo heshje e juaja më tepër për shkak të statusit?*

Xhavit Haliti: Po, është e vërtetë se në këto dy vitet e fundit në veçanti në Parlamentin e Kosovës debatet, kundërshtitë dhe përplasjet politike janë ndalur për shkak të procesit të statusit, por edhe për arsye që nuk do të ishte mirë që t'i kuptojë opinionin sepse do të ndërroheshin pastaj edhe të implikuarit në këto çështje dhe do të krijohet një situatë e pal-

akmueshëm në Kosovë kur të merren vesh të gjitha marifetet që janë bërë prapa krahëve të popullit, prapa Kuvendit. Jo vetëm proceset politike, por edhe proceset e interesave të mëdha ekonomike dhe strategjike të Kosovës janë goditur nga rrjete të cilat nuk e meritojnë të jenë jo vetëm në tregun politik.

*Pyetje: A ju vjen keq që tani për shkak të statusit nuk mund të tregoni para Kuvendit dhe qytetarëve se për cilat rrjete është fjala, të cilat sipas jush kanë goditur rëndë proceset ekonomike dhe strategjike në vend?*

Xhavit Haliti: Vërtetë ndihem shumë keq. Tani nuk mund të flasim për këto për shkak të statusit ndërsa periudhat e debateve post-festum nuk do të kenë peshë fare e as vlerë. Ta zëmë nëse ne sot debatojmë për një çështje e cila ka kaluar dhe ka filluar të implementohet- atëherë ne bëjmë debat kot.

Por nuk e përjashtoj mundësinë që pas zgjidhjeve të ardh-

shme Qeveria që do të zgjidhet do të jetë e përgjegjshme dhe do të kërkojë një revizion dhe të kontrollojë rreptë gjithë procesin vendimmarrës, veçanërisht proceseve të cilave u është krijuar hapësirë përmes tenderëve të ndryshëm korrptiv që këta që kanë lejuar të ndodhin këto duke shkelur ligjin të dalin para drejtësisë.

*Pyetje: T'i kthehemi edhe njëherë punës së Kuvendi. A është i përgatitur dhe a ka kapacitete Kuvendi të miratojë të gjitha ligjet që dalin nga Pakoja e Ahtisaarit?*

Xhavit Haliti: Ne kemi vështirësitë tona edhe si Kuvend por edhe si institucione për shkak se nuk kemi përvojë të madhe, për shkak të mungesës së kapaciteteve profesionale por megjithatë unë besoj se do të arrijmë të miratojmë të gjitha ligjet që dalin nga pako e Ahtisaarit. Ne në një mbledhje të Kryesisë kemi marrë vendim që Kuvendi të mos pushojë sivjet gjatë verës por të punojë, qoftë nevoja të mbliidhet edhe për

çdo ditë për të miratuar ligjet që dalin nga marrëveshja për statusin. Kjo është detyrë e jona edhe obligim i yni edhe karshi qytetarëve që na kanë zgjedhur por edhe përballë partnerëve tanë ndërkombëtarë. Kryesia do të jetë edhe me angazhuar gjatë kësaj periudhe por edhe qeveria duhet të jetë më aktive në përgatitjen e ligjeve.

*Pyetje: A ka rrezik që këto ligje të mos miratohen për shkak të lëkundjeve të fundit që kanë ndodhur në Ekipin negociator dhe duke pasur parasysh edhe ndarjen e LDK dhe krijimin e LDD-së?*

Xhavit Haliti: Kosova ka politikanë të përgjegjshëm dhe kjo më bënë që të besoj se nuk do të kemi pengesa në miratimin e këtyre ligjeve. Jam i bindur se Kuvendi nuk do të ketë pengesa në miratimin e ligjeve për shkak të problemeve që cekët. GP i PDK do të jetë i përgjegjshëm dhe do të angazhohet në miratimin e ligjeve që dalin nga pako e Ahtisaarit.

*Mahir Yagcilar,  
deputet i Kuvendit të Kosovës nga PDK-ja*

Me vite të tëra, Kosova ka qenë në fokus të interesimeve të qarqeve politike botërore dhe publike lidhur me konfliktet, shkeljet e të drejtave të njeriut, besimit ndërmjet komuniteteve dhe çështjes së ndërtimit të së ardhmes. Megjithatë, këto ditë Kosova ka rastin të jetë fokus i interesimit të publikut botëror, si një shembull i asaj se si mund të zgjidhen problemet në mënyrë paqësore dhe me marrëveshje, se si Kosova mund të jetë dhe mund të bëhet vend i shpresës dhe jetës moderne. Vend i përparimit dhe bashkëjetesës. Vend i stabilitetit dhe paqes së qëndrueshme. Krijimi i paqes së qëndrueshme dhe stabilitetit është akoma fakt shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të çdo shoqërie. Në shoqëritë shumetnike dhe shoqëritë pas konfliktit ky fakt është duke fituar çdo herë e më shumë rëndësi, meqë ka shumë faktorë potencial, të cilët e rrezikojnë paqen dhe stabilitetin. Pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, në çdo shoqëri, të gjithë qytetarët kanë nevojë për një jetë normale dhe të sigurtë, si dhe shpresë për një të ardhme më të mirë. Megjithatë, mungesa e aparatit të duhur shtetëror funksional dhe prania e një gjendjeje të papërcaktuar ekonomiko-politike për sa i përket së ardhmes, shtojnë potencialet për destabilizimin e situatës. Kështu që, çdo shoqërie i nevojiten mekanizma për krijimin e paqes dhe stabilitetit, siç është përcaktimi ekonomiko-politik i shoqërisë.

Në çdo shoqëri, çdo komunitet dhe çdo individ ka rolin e vet përkatës në krijimin e paqes dhe stabilitetit, që nënkuptojnë kush-





# Kosovës i është ofruar mundësia



tet për një jetë normale. Shteti, kryesisht me komunitetin shumicë ka rol për të krijuar mekanizmin legjislativ dhe kushte tjera paraprake për ndërtimin e paqes dhe stabilitetit, për krijimin e parakushteve në të gjitha sferat e shoqërisë, të drejtat për komunitetet minoritare, lirinë e lëvizjes, përdorimin e gjuhës, qasjes në media, një sistem arsimimi që respekton dhe avancojnë komunitetet përmes kushtetutës dhe sistemit ligjor. Në anën tjetër, komunitetet minoritare dhe pjesëtarët e tyre kanë rol, që gjatë kërkimit të të drejtave të tyre, të parashikojnë gjithashtu përgjegjësitë, siç është pjesëmarrja aktive në jetën politike, zhvillimin ekonomik, mirëqenien sociale, sistemin arsimor dhe krijimin e shoqërisë së lirë dhe demokratike, me fjalë të tjera integrimin dhe pjesëmarrjen në krijimin e shoqërisë së tyre.

Pa dyshim, Kosova është një shembull ku ekziston një sistem i mirëfilltë demokratik dhe sundim i ligjit dhe vend ku mund të zhvillohet paqja e qëndrueshme dhe stabiliteti. Kosova me dinamikën e saj dhe gjeneratat e reja kërkojnë këtë dhe çfarëdo shtyrje për identifikimin e zgjidhjes së statusit të

Kosovës do të krijonte probleme të reja dhe humbje të besimit dhe durimit tek qytetarët. Prandaj, pavarësisht nga këto mangësi dhe kërkesave të fuqishme për implementim, propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, i prezantuar nga presidenti Ahtisaari ofron mundësinë për zbatimin e paqes së qëndrueshme dhe stabilitetit në Kosovë dhe në këtë pjesë të Ballkanit. Kjo ofron një shpresë për të ardhmen dhe hap një faqe të re në marrëdhëniet ndërmjet qytetarëve të Kosovës dhe ndërmjet komuniteteve të Kosovës. I ofron një mundësi shumicës për të administruar, por edhe respektim të komuniteteve minoritare. Propozimi i Ahtisarit krijon një koncept të ri të qeverisjes, dhe të aktiviteteve që duhet zhvilluar nga ana e komuniteteve në kuadër të statusit të ri për Kosovën. Ky koncept bazohet në mekanizmat e qartë për mbrojtje dhe veprim, që nënkupton një shoqëri aktive, komunitet aktiv, parti politike aktive dhe shoqëri civile aktive. Është koncept që kërkon besim të ndërsjellë dhe ndërveprim, por gjithashtu ofron mekanizma për mbrojtje, në rast se ky besim keqpërdoret.

Nga pikëpamja e komuniteteve minoritare, propozimi ofron garancione të caktuara për mbrojtjen e identitetit të komunitetit të shprehur përmes gjuhës, kulturës, arsimit dhe përfaqësimit politik dhe vetëqeverisjes vendore. Ky propozim i ofron mundësi komuniteteve që të jenë faktorë vendimtar në miratimin e ligjeve me interes të veçantë për komunitetin, por në të njëjtë kohë edhe i inkurajon komunitetet që të jenë të aktiv dhe bashkuar politikisht. Kjo ofron mundësinë e përfaqësimit në institucionet më të rëndësishme shtetërore, siç është parlamenti, qeveria, komisioni kushtetues dhe gjykata kushtetuese, sistemi gjyqësor, komunat, këshillat shtetërore dhe agjencitë. Me fjalë të tjera, propozimi për status i ofron kompetencë të caktuar komuniteteve, që duhet ta shfrytëzojnë në mënyrë të pjekur dhe konstruktive.

Zgjidhja e propozuar mund të mos jetë e përkryer, por për momentin është zgjidhje e vetmja e mundshme, meqë ia hap rrugën Kosovës drejt integritimit evropian si dhe në klubin e shteteve moderne të botës. Kështu që, të gjitha komunitetet dhe qytetarët e Kosovës, në emër të së ardhmes së tyre duhet ta pranojnë propozimin e presidentit Ahtisari dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në zbatimin e zgjidhjes së propozuar. Zgjidhja e propozuar ofron vetëm parakushte dhe garancione minimale, përderisa kushtetuta e re e Kosovës dhe ligjet themelore të saj duhet të krijohen një sistem të ri ekonomiko-politik në Kosovë, që duhet të jetë funksional, të krijojë besim ndërmjet komuniteteve si dhe

të japë shpresë për një jetë më të mirë të të gjithë qytetarëve të Kosovës.


Në këtë rast të veçantë, komuniteti shumicë shqiptar duhet të jetë i angazhuar plotësisht gjatë kësaj periode, kështu që dispozitat nga ky propozim do të pasqyrohen në kushtetutën e re të Kosovës, në ligjet themelore dhe në zbatimin e zgjidhjes në jetën e përditshme. Të vepruarit në këtë mënyrë do të krijojë besim tek komuniteti ndërkombëtar dhe do të demonstroj partneritet të përhershëm me komunitetin ndërkombëtar.

Në anën tjetër, roli i komuniteteve minoritare është që të jenë aktiv, konstruktiv dhe të bashkëpunojnë me shumicën dhe komunitetin ndërkombëtar në zbatimin e propozimit për zgjidhje.

Vitin e kaluar gjatë procesit të negociatave, komuniteti turk ka marrë pjesë aktive dhe konstruktive, dhe pas marrjes në parasysh të kërkesave themelore të komunitetit turk lidhur me gjuhën, arsimin dhe të drejtat ekzistuese të trashëguara sipas legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë. Komuniteti turk dhe partia të cilën e përfaqësoj, me të kuptuar rëndësinë e situatës dhe rolin e tyre gjatë kësaj periode kritike, ka pranuar zgjidhjen e propozuar të presidentit Ahtisari dhe ne jemi të gatshëm të marrin pjesë në mënyrë aktive në proces, gjithashtu të marrin pjesë për barrën e punëve dhe përgjegjësitë së bashku me gjithë të tjerët, pasi që Kosova është vendi ku ne jetojmë dhe atdheu në të cilin ne shohim të ardhmen tonë individuale dhe të përbashkët.

# Për statusin e Kosovës dhe pas Ahtisaarit

Dušan Janjić, PhD, Kryetari i Forumit për Marrëdhënie Etnike, Beograd



Përkundër faktit që misioni i Ahtisaarit në përgjithësi gëzon përkrahje nga BE-ja dhe SHBA-të, nuk ka pajtueshmëri me gjitha lëvizjet apo detajet e propozuara nga ai.

Një nga komentet e shpeshta ndaj qasjes së Ahtisaarit ishte fakti që bisedimet mbi statusin e ardhshëm të Kosovës kanë qenë të pasuksesshme, sepse ai nuk ka pranuar plotësisht faktin që Serbia është shtet i pavarur dhe demokratik, si dhe që ai ka trajtuar ndaras çështjet e marrëveshjes dhe territorit të Kosovës, me çështjet e marrëveshjes dhe territorit të Serbisë. Përgjigja e Ahtisaarit ndaj këtyre komenteve ka qenë që ai nuk ka dëshiruar të vazhdojë të bindë Serbinë, por të zgjidhë çështjen e Kosovës. Në fakt, Ahtisaari dështoi të definojë statusin e ardhshëm të Kosovës, pasi marrëdhëniet e ardhshme mes Kosovës dhe Serbisë së këndejmi bisedimet e Vjenës, mund të konsiderohen si “rast i humbur”.

Propozimi gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kos-

ovës i Ahtisaarit, sidomos disa zgjidhje që dalin nga anekset, mund të pranohet si “pozitiv e mirë fillestar” për vazhdimin e procesit. Megjithatë, kjo duhet të marrë pajtueshmërinë e Grupit të Kontaktit. Për të arritur këtë marrëveshje, korniza e Grupit të Kontaktit përkohësisht është lënë anash, ndërsa është kërkuar ndihmë nga Këshilli i Sigurimit të KB.

Pas diskutimit në seancën e Këshillit të Sigurimit të KB-së, të mbajtur më 3 prill 2007, si dhe propozimit nga Rusia, u vendos që të themelohet një Mision i Këshillit të Sigurimit i cili do të “verifikonte” përmes bashkimit të Standardeve për Kosovën. Në të vërtetë, “konsultimet teknike” të Këshillit të Sigurimit të KB-së kanë filluar të synojnë ratifikimin e pajtimit të mundshëm të qëndrimit të Grupit të Kontaktit me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të KB-së.

Rezoluta e re i shërben faktit që nuk ka aq shumë njerëz që janë të kënaqur me punën e UNMIK-ut dhe vetë Misionin, që në përgjithësi është vlerësuar si “rast i humbur”. “Ekziston një mendim i përgjithshëm që status-kuoja aktuale është e keqe, por edhe mendimi që zgjidhja e njëanshme vetëm sa do ta thellojë krizën.

Pasi angazhimi i Bashkimit Evropian si pjesë e UNMIK-ut, ka qenë pa ndonjë strategji të qartë deri tani, ndërsa uniteti politik i anëtarëve të BE-së ka ekzistuar vetëm në raste, është e dukshme që BE-ja është tejte e përfshirë në Kosovë për të dalë lehtës prej aty, dhe ekzis-

ton një qëndrim i pranuar që ka nevojë për një rezolutë të re për të mundësuar që BE-ja të marrë mbi vete Misionin në Kosovë, si dhe të definojë qartë mandatin.

Në këtë rast, propozimi i Ahtisaarit dhe raporti i Kai Aides mund të ndihmojnë shumë për të definuar qartë mandatin e prezencës civile ndërkombëtare.

Në lidhje me praninë ushtarake ndërkombëtare, dimensionin e dytë i pranisë ndërkombëtare në pajtim me Rezolutën 1244, ekziston një pajtueshmëri e përgjithshme që është e domosdoshme, që duhet të vazhdojë, si dhe që NATO duhet ta ushtrojë atë në të ardhmen. Kjo prani sigurisht që duhet të jetë në gjendje të përballet me sfidat e krimit të organizuar dhe terrorizmit në mënyrë më efektive, gjë që përfshin edhe reformën e sistemit të sigurisë në Kosovë. Pasi autoritetet serbe janë pajtuar gjithashtu me rolin e NATO-s, si dhe vetë Serbia si anëtare e Partneritetit për Paqe ky problem duhet të zgjidhet brenda sistemit të NATO-s.

Për publikun e Serbisë, si dhe serbët e Kosovës, debati i prillit në Këshillin e Sigurimit është paraqitur si fitore e Ekipit Negociues të Beogradit. Presidenti Koshtunica ishte i pari që nga Selia e KB-së tha: Plani i Ahtisaarit ka dështuar! Kjo do të thotë që publiku në Serbi do të vazhdojë të mos jetë i informuar për procesin, si dhe nuk do të ketë ndryshime në politikën e Beogradit ndaj Kosovës. Kjo e fundit është udhëhequr me moton “Nuk

do ta njohim pavarësinë e Kosovës”! Përveç kësaj, Beogradi zyrtar ushqen shpresën që do të ketë negociata të reja, “të vërteta”. Megjithatë, ka pak shpresë që Beogradi të shfrytëzojë në mënyrë produktive konsultimet vijuese të Këshillit të Sigurimit për të përmirësuar qëndrimet e tij. Beogradi nuk është plotësisht i vetëdijshëm që propozimi i Ahtisaarit është ende në tavolinë dhe ky fakt e bën situatën edhe më të vështirë.

Derisa proceset e mëtejme janë në diskutim, ka rrezik që situata në Kosovë të dalë nga kontrolli, ndonëse është duke u kontrolluar me sukses në një mënyrë. Ekzistojnë disa rreziqe: 1. Dobësia e UNMIK-ut – si dhe qëndrimi evident i diplomatëve dhe burokratëve ndërkombëtarë, të cilët trimërojnë ide të ndryshme të “fundit të agonisë”, me “presion” të shtuar mbi serbët dhe Beogradin; 2. Dobësimi i Qeverisë Çeku, pas nisjes së Ramush Haradinajt për në Hagë, si dhe apetiti i ngjallur politik i Hashim Thaçit dhe ngurrimit të PSSP-së për të iniciuar një riorganizim të Qeverisë së Kosovës, inkurajojnë lindjen e betejave politike mes shqiptarëve, si dhe drejtimin e pakënaqësisë së shqiptarëve drejt komunitetit serb; 3. Mes serbëve në Kosovë, është lehtë të dallohet një “dinamikë e çuditshme” e cila shumë lehtë dhe shumë shpejt mund të dalë nga kontrolli si dhe të kthehet në vetë-mbrojtje ose një eksod. Ka të bëjë me ankthin, pasigurinë dhe frikën nga ajo që do të ndodhë pas “pranimit të planit të Ahtisaarit”.

# Procesi i definimit të statusit të Kosovës: të arriturat dhe mangësitë

Shkruan: Emrush Xhemajli deputet i Lëvizjes Popullore të Kosovës



Lëvizja Popullore e Kosovës nuk ka qenë pjesë e përfshirjes në Bisedimet e Vjenës. Megjithatë ne kemi përcjellur me vëmendje procesin e këtyre bisedimeve nga të cilat doli Plani për Kosovën i Presidentit Ahtisari.

Është me rëndësi të veçantë se në Rekomandimin përcjellës të Pakos së Presidentit Ahtisari të datës 26 mars 2007 drejtuar antarëve të Këshillit të Sigurimit të OKB-së në mënyrë eksplicite qartësohet statusi i ardhshëm i Kosovës, pavarësi e cila në fillim do të mbikqyret nga një mision i ardhshëm ndërkombëtar me qëllim të zbatimit të planit për Kosovën. Ky dokument dhe fleta përcjellëse e SP të OKB-së e z. Ban Ki Mun, janë të arritura për Kosovën dhe për zhvillimet paqësore e demokratike në rajon.

Për Kosovën është sukses rritja e besimit në botë se Kosova mund dhe duhet të qeveriset nga qytetarët e

saj sado që ende ky besim duhet rritur dhe ndërtuar në vijimësi në të ardhmen. E arritur tjetër është se bota ka kuptuar se status-kuoja e tashme në Kosova është e paqëndrueshme dhe rrezikshme, se qytetarët kanë të drejtë të kenë të ardhme dhe vendit t'i mundësohet zhvillim normal.

Për këtë arsye, për pikëpamjen tonë, dokumenti gjithëpërfshirës për Kosovën i Presidentit Ahtisari është një hap përcaktues përpara. Megjithatë për mendimin tonë ky dokument nuk është krejt ajo që i takon shumicës së qytetarëve të Kosovës, sipas masës dhe mënyrës së të drejtave që i kanë popujt dhe vendet në rajon. Për këtë arsye duhet edhe shumë rrugëtim dhe punë deri në rregullimin e një statusi përfundimtar të Kosovës,

Sa u përket disa pjesëve dhe detajeve konkrete të Planit të Ahtisarit për mendimin tonë zbatimi në praktikë do të jetë i vështirë sepse nuk janë në pajtim me gjendjen dhe zhvillimet e përgjithshme në terren.

Për mendimin tonë Kosova duhet të jetë shtet unitar me respektim të plotë të pakicave sepse ka një shumicë të qartë (90 për qind) dhe disa pakica që përbëjnë pjesën tjetër (10 për qind). Në dokumentin e Ahtisarit nuk ndiqen kriteret sikurse në vendet e Evropës me strukturë të popullatës, të ngjas-

hme me Kosovën. Kjo e vështirëson dhe komplikon funksionimin unik e demokratik të vendit në fushën e arsimit, në fushën e shëndetësisë, në fushën e financimit, në fushën e trashëgimisë kulturore dhe në fushën e sigurisë dhe sundimit të ligjit për të gjithë qytetarët njësoj.

Të metat më të vërejtshme në këtë planë janë në mënyrën e votimit të dyfishtë në Parlamentin qendror të Kosovës ku nuk përcaktohen taksativisht se në çfarë fusha, dhe në çfarë rastesh do të ndodh ky lloj votimi. Në praktikë kjo mund të qojë deri te vështirësitë apo edhe bllokimi i punës në Kuvend.

Edhe pse diskriminimi pozitiv për pakicën serbe në Pako është bërë me qëllim në të mirë për mendimin tonë me kalimin e kohës mund të bëhet e metë e projektit sepse krijon debalanc në nivel regjional dhe mund të përcillet me probleme në vendet tjera si në Maqedoni, Serbi dhe Mal të Zi (atje pakicat mund të kërkojnë të njëjtat të njëjtin diskriminim pozitiv pa një shpresë të madhe për realizim). Këto çështje vetvetiu do të ngjallin pakënaqësi dhe do të reflektohen negativisht në Kosovë.

Në fushën e decentralizimit e meta më e madhe e disa pjesëve të Pakos është se duke mos qenë decentralizimi gjithëpërfshirës, në të gjithë Kosovën, ka mbetur

decentralizim në baza etnike. Këtu nuk është marrë për bazë kriteri i njohur i afrimit të shërbimeve më të afërta, më të shpejta dhe më efikase për qytetarin. Me këtë formë veç tjerash do të ketë vështirësi në implementim të kësaj forme në terren dhe e dyta mund të ndodh një disproporcion i theksuar në madhësinë e granteve komunale dhe i financave për kokë të banorit.

Ne mendojmë se në Planë ka dobësi në mënyrën e vendosjes dhe qëndrimit të misionit të ardhshëm ndërkombëtar. Mosdefinimi i qartë i kohës së përfundimit të misionit këtu, duke u bazuar edhe në përvojën nga misioni i tashëm mund të thuhet se është një e metë e planit. Në plan nuk është përfshirë edhe detajet që do të bënin funksionale dy pushtetet paralele që do të ekzistojnë në Kosovë në fusha të caktuara. Kjo le hapësirë për pengesa reciproke, fërkime e ndoshta edhe kundërshti që mund ta pengojnë zhvillimin normal të vendit.

Si përfundim. Kanë kaluar 8 vite nga përfundimi i luftës çlirimtare. Koha e humbur tani duhet kompensuar me punë të përqendruar të institucioneve të Kosovës dhe në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar vendi ynë kemi arsye të besojmë se do të tregohet i suksesshëm.





## Deklarata e Misionit të ASI-t

Iniciativa për Mbështetje Kuvendit është një mekanizëm koordinues mes agjensioneve të ndryshme për programe demokratizimi në mbështetje të punës së Kuvendit të Kosovës si dhe fuqizimin dhe profesionalizimin e Kuvendit të Kosovës. Puna e ASI-t përqëndrohet në kulturën demokratike politike të bazuar në njohjen dhe respek-timin e rregullave demokratike të punës, transaprencës dhe përgje-gjshmërisë ndaj opinionit publik, zhvillimit dhe implementimit të agjendës legjislative, mbikëqyrjes mbi Ekzekutivin, respektin për shumëgjuhësinë dhe pjesëmarrjen në kontakte të ndryshme rajonale dhe ndërparlamentare.

Partnerët e ASI-t punojnë për të bashkuar resurset, shkëmbyer informacionin dhe koordinuar programet duke identifikuar nevoajt në një interaksion të drejtëpërdrejtë me Kuvendin. Si koordinator i ASI-it Misioni i OSBE-së në Kosovë ndërldihet me gjithë partnerët e ASIT dhe fton në takime të rregullta koordinuese gjithnjë në konsultim dhe përfaqësuesit e Kuvendit. Buletini i rregulltë i ASI-t informon publikun vendas dhe ndërkombtarë mbi zhvillimet në Kuvendin e Kosovës dhe programin mbështetës të ASI-t.

*Anëtarët të tanishëm të ASI-t:*

*Friedrich Ebert Stiftung (FES), Friedrich Naumann Stiftung (FNSt.) Konrad Adenauer Stiftung (KAS), Projekti i Praktikave Parlamentare Lindje-Perëndim (EWPPP), Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER) në bashkëpunim me Konzorciumin e parlamenteve të Francës, Gjermanisë, Belgjikës, Sllovenisë dhe Institutin për Mbrojtje të Parisit, Agjencioni Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Nacional Demokratik (NDI), Programi Zhvillimor i KB-ve (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërpametar (IPU), Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Kuvendi i Kosovës.*



Këshilli redaktues:

Ramë Manaj, Skender Durmishi, Sven Lindholm, Blerim Vela, Alfons Lentze, Edmond Efendija, Krenar Loshi, Franklin De Vrieze.

Redaktorët: Jennifer Ober, Anna Richards, Nuno Luzio.

Grafika dhe faqosja: Shpend Kada, Edi Agagjyshi

Selia e Misionit të OSBE, 10000 Prishtinë  
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188  
kontakt: franklin.devrieze@osce.org  
<http://www.osce.org/kosovo>

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetem atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t.

Fotografitë e këtij buletini :

OSCE: 2, 5, 6, 9, 13, 17, 21, 24, 27, 31, 32, 33, 34;  
UNOSEK: 3, 18; UNMIK: 10, 22; Koha Ditore 11